



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE
FONDET NË MIRËBESIM
PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018

PËRMBAJTJA

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM.....	5
GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM	6
HYRJE NË SHËNIMET SHPJEGUESE.....	8
BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE	8
SUBJEKTI RAPORTUES.....	8
RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË.....	9
VALUTA RAPORTUESE.....	9
DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE.....	9
TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	10
1. TË HYRAT NGA SHITJA.....	10
2. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË	12
3. INTERESI I FITUAR	15
4. TARIFA PËR PJESËMARRJE NË TENDERËT E SHITJES DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE	16
5. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER.....	17
6. TË HYRAT E TJERA	18
7. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	19
SHPENZIMET/SHPËRNDARJA	20
8. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK	20
9. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSHP)	21
10. MALLRA DHE SHËRBIME	23
10.1 PAGESAT NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMEVE	24
11. SHËRBIMET PUBLIKE	27
12. TATIMET	28
13. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE	29
14. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-SË	31
14.1 TË HYRAT E REALIZUARA PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT.....	32
15. SHPENZIMET TJERA	33
16. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE NË LIKUIDIM.....	34
17. FONDET E TRANSFERUAR BUXHETIT TË KOSOVËS.....	36
LLOGARITË E ARKËTUESHME	38
18. NDËSHKIMET NDAJ NSH-VE ME SPIN-OFF SPECIAL.....	39
19. SHITJA E ASETVE	40
20. QIRAJA DHE TË HYRAT TË TJERA	42
LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE.....	44
21. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE	45
22. MALLRA DHE SHËRBIME	45
23. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE	46
24. DETYRIMET KONTIGJENTE.....	46

PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE	49
TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE	50
TRANSFERET BRENDË LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM	50
LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE	50
GJENDJA E FONDEVE TË LIKUIDIMIT TË NSH-VE.....	51
LLOJET E LLOGARIVE BANKARE	53
PLANI I VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM (AP) TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS TË DHËNA NË RAPORTIN E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË VITIT 2017 PËR FONDET NË MIRËBESIM	54

PASQYRAT FINANCIARE 2018

- **PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM**
- **GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM**

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2018

	Shënimet shpjeguese	2003 deri me 31 dhjetor 2017	Periudha 1 janar 31 dhjetor 2018	2003 deri me 31 dhjetor 2018
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE				
Të hyrat nga shitjet	1	697,169,916	18,138,724	715,308,640
Të hyrat nga qiraja	2	32,562,651	6,268,014	38,830,665
Interesi i fituar	3	34,844,700	-	34,844,700
Tarifa për pjesëmarrje në tenderët e shitjes dhe konfiskimet e BID depozitave	4	8,229,964	89,900	8,319,864
BID depozitat e ofertueve	5	2,030,820	(1,187,620)	843,200
Të hyra të tjera	6	6,866,535	397,439	7,263,974
Kapitali themeltar i Agjencisë	7	1,013,200	-	1,013,200
GJITHSEJ PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE		782,717,786	23,706,457	806,424,243

PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË

20% i punëtorëve transferuar në BSPK	8	119,257,304	6,970,480	126,227,784
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	9	15,419,930	581,000	16,000,930
Mallra dhe shërbime	10	14,381,184	1,941,882	16,323,066
Shërbime publike	11	1,994,309	412,063	2,406,372
Tatimet	12	5,011,966	1,122,325	6,134,291
Taksa/depozita të Gjykatave dhe vendimet e gjykatave/përmbaruesve	13	1,808,211	707,711	2,515,922
Transferimi i mjeteve 5% për aktivitetet e AKP-së	14	38,248,000	6,493,706	44,741,706
Shpenzimet tjera	15	749,541	37,650	787,191
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-ve	16	23,977,884	2,476,127	26,454,011
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	17	90,570,575	86,146,458	176,717,033
GJITHSEJ PAGESAT/SHPËRNDARJA		311,418,904	106,889,402	418,308,306

gjendja në llogaritë bankare

	31 dhjetor 2017	2018 Hyrje/Dalje	31 dhjetor 2018
BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE	471,298,882	(83,182,945)	388,115,937

GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2018

	JANAR DHJETOR 2018	JANAR DHJETOR 2017	JANAR DHJETOR 2016
Privatizim	8,664,975	8,986,889	9,682,795
Likuidim	357,793,520	432,327,446	411,464,705
Para të NSh-ve në mirëbesim	6,385,213	5,325,079	5,016,134
Komercializim	-	-	3,667,287
Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	13,208,013	15,400,400	21,121,998
Depozita nga tenderët e privatizimit	-	-	-
Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	-	-	-
Depozita nga tenderët e shitjeve me Likuidim	850,336	2,039,421	602,159
Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim	14,083	14,989	65,099
Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit	25	25	25
Kapitali themeltar i AKP-së	1,048,861	1,109,549	1,109,549
Fondi rezervë i AKP-së	-	-	1,000,000
Donator	8,463	8,463	8,463
Tarifa administrative e AKP-së	142,447	6,086,620	7,223,136
Depozitat Kohor	1	1	-
Të hyrat nga shpronësimet	-	-	-
GJITHSEJ	388,115,937	471,298,882	460,961,350

Llogaritë bankare në Bankën Qendrore të Kosovës të cilat i administron AKP-ja janë të shpalosura në fund të shënimeve shpjeguese.

SHËNIMET SHPJEGUESE 2018

HYRJE NË SHËNIMET SHPJEGUESE

BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik. Në përputhje me SNKSP, këto pasqyra janë prezantuar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Gjithashtu, këto pasqyra financiare i përmbushin obligimet raportuese që dalin nga “Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim” e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011.

Meqenëse pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në pajtim me SNKSP, janë përfshirë edhe **llogaritë të arkëtueshme, llogaritë e pagueshme dhe detyrimet kontingjente vetëm si shpalosje në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim.**

Të gjitha të dhënat financiare të pranimeve dhe pagesave që janë paraqitur në këto shënime janë nga llogaritë bankare të NSh-ve që Agjencia menaxhon dhe administron në **Bankën Qendrore të Kosovës**. Të dhënat nuk paraqesin rezultate të NSh-ve që kanë pasur apo kanë aktualisht menaxhmentin aktiv, të cilët kanë menaxhuar apo administruar me llogaritë bankare në bankat komerciale.

AKP ka vendosur në dispozicion shtojcat e pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim, raporte të cilat janë të detajizuara që paraqesin bilancet përfundimtare dhe transaksionet e ndodhura gjatë periudhës raportuese. Këto raporte paraqesin detajet e kategorizuara sipas planit kontabël të fondeve në mirëbesim për llogaritë bankare që administrohen nga AKP. Shtojca e pasqyrave financiare i dorëzohen Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, që do të shërbejnë për analiza dhe krahasime më detaje të të dhënave financiare që janë paraqitur në pasqyrat financiare.

SUBJEKTI RAPORTUES

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 1 korrik 2008 e ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 shtator 2011 dhe ndryshim/plotësimet të Ligjit nr. 04/L-115 të datës 7 shtator 2012, të Ligjit nr. 05/L-080 të datës 24 dhjetor 2015 dhe ligjit nr. 06/L-023 të datës 3 maj 2018.

Në pajtim me Ligjin mbi themelimin e AKP-së, aktiviteti i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh) nëpërmjet metodave të “spin off-it”, qiradhënie, administrimi, ristrukturimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore sipas Ligjit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit menaxhon Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në Mirëbesim. AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës së NSh-ve dhe aseteve të tyre brenda dhe jashtë Kosovës.

Periudha raportuese për pasqyrat financiare është prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2018. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raporte që paraqesin të dhënat financiare nga data **1 korrik 2003 deri më 31 dhjetor 2018.**

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit.

Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 8 të Ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080.

Mandati (dyvjeçar sipas dispozitës paraprake ligjore) i gjashtë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve ka përfunduar në muajin dhjetor 2017. Pas skadimit të mandatit, Kuvendi ka emëruar anëtarët e rinj e Bordit më datën 31 maj 2018, të cilët kanë mandat 4 vjeçar në përputhje me nenin 9 të Ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080.

Ndërsa mandati i Kryesuesit (që ka dhënë dorëheqje në fund të tetorit 2018) dhe mandati i Zëvendës Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve ka skaduar në muajin dhjetor 2018. Nga gjashtë anëtarët e mbetur të Bordit të Drejtorëve, në muajin dhjetor 2018 është emëruar Zëvendës Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

Pozitat e Kryesuesit dhe një anëtar i Bordit të drejtorëve të AKP-së pritet të emërohen nga Kuvendi i Kosovës.

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur në muajin tetor 2018, ka liruar nga detyra Drejtorin Menaxhues z. Ekrem Hajdari dhe më mbledhjen e mbajtur në nëntor 2018 ka emëruar Drejtorin Menaxhues z. Valon Tolaj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura. Raporti vjetor paraqet të gjitha detajet e aktiviteteve dhe informatave financiare dhe jofinanciare për vitin fiskal 2018.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË

AKP-ja menaxhon dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP-ja bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi i urdhër-transfereve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve.

VALUTA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.

DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim më datën **30 Janar 2019** nga: Valon Tolaj, Drejtor Menaxhues dhe Adem Selishta, Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE

1. TË HYRAT NGA SHITJA

Të hyrat e realizuara nga shitja paraqesin bilancet e pagesave deri më **31 dhjetor 2018** të hyrjeve dhe daljeve në llogaritë bankare të Ndërmarrjeve Shoqërore (fondet në mirëbesim) të cilat administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Pasqyra e Pranimeve për shitjet paraqet gjendjen fillestare bankare më 31 Dhjetor 2017, gjendjen e transaksioneve Hyrëse/Dalëse gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2018 dhe gjendjen përfundimtare bankare më 31 dhjetor 2018.

Tabela e mëposhtme paraqet bilancin e pranimeve për periudhën raportuese sipas llojeve të shitjeve:

LLOJET E SHITJEVE	SHUMA
Shitjet e aseteve Përmes Valëve të Likuidimit <i>[referoju dhe tabelës A1]</i>	16,791,835
Shitjet e aseteve nga negociimi direkt <i>[referoju dhe tabelës A1]</i>	412,945
Pagesat e realizuara nga Qeveria për shpronësimet e aseteve	924,338
Të hyra nga bartja e së drejtës banesore	9,606
GJITHSEJ	18,138,724

SHPJEGIM LIDHUR ME SHITJET E ASETEVE PERMES VALEVE TE LIKUIDIMIT DHE NEGOCIMIT DIREKT

Ashtu siç është paraqitur më lartë, shuma totale prej **EUR 16,791,835** e shitjeve të aseteve përmes valëve likuidimit paraqet bilancin e pranimeve të realizuar gjatë procesit të shitjes. **Ndërsa vlera e të hyrave nga kontratat e nënshkruara**, gjatë kësaj periudhe raportuese është gjithsej **EUR 19,226,403 (121 kontratave përfshirë shitjet e tenderuara gjatë vitit 2017)**. *Detajet e tjera janë të paraqitura në raportin e akviteteteve të AKP-së.*

E njëjta vlen edhe për shitjet e aseteve përmes negociimit direkt për të cilat ende nuk është finalizuar nënshkrimi i kontratave.

TABELA A1 - PASQYRA E PRANIMEVE DHE REALIZIMIT TË SHITJEVE (KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA)

PËRSHKRIMI	RENDITJA	VLERA
Pagesat e realizuara në vitin 2017 për kontratat e nënshkruara 2018	1	4,076,902
Bilancet e pagesave të realizuara gjatë vitit 2018	2	15,149,501
BID depozitat të pa transferuar të kontratave të nënshkruara 2018	3	-
Gjithsej pagesat e realizuara për kontratat që janë nënshkruar në vitin 2018	4=Σ(1:3)	19,226,403
<i>Pranimet gjatë vitit 2018 të kontratave të nënshkruar dhe panënshkruara</i>		
Bilancet e pagesave të realizuara gjatë vitit 2018	A	15,149,501
Bartje e BID depozitave për kontratat e vitit 2017 <i>[pa bartur në fund të vitit 2017]</i>	B	3,000
*Pranimet nga shitjet - kontratave ende të panënshkruara	C	1,639,334
GJITHSEJ BILANCI I PAGESAVE PËR VITIN 2018	D=Σ(A:C)	16,791,835

*Përshinë pagesat e shitje përmes negociimit direkt prej EUR 412,945 dhe shitjes të aseteve përmes likuidimit prej EUR 1,226,389.

SHITJET PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT janë shitjet e realizuara të Ndërmarrjeve të Reja të themeluara nga asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore. Me shitjen e këtyre Ndërmarrjeve të Reja transferohen edhe një pjesë e obligimeve tek blerësit si p.sh. obligimet e shërbimeve publike, tatimore apo obligime të tjera komunale.

AKP për vitin raportues, nuk ka përdor këtë metodologji të “Shitjeve të Ndërmarrjeve të Reja”, pasi që shumica e NSh-ve kanë hyrë në likuidim, asetet e të cilave shiten **përmes procesit të likuidimit**. Andaj, për periudhën raportuese nuk kemi mjete të pranuar nga të shitjet përmes valëve të privatizimit të Ndërmarrjeve të Reja.

SHITJET E ASETEVE PËRMES METODËS TË NEGOCIMIT DIREKT

Në përputhje me paragrafin 1.4 të nenit 18 të shtojcës të Ligjit bazik nr. 04/L-034 dhe rregullores për “Shqyrtimin e Aseteve me Karakter Specifik dhe Shitja e tyre me Negocim Direkt” AKP-ja ka filluar procesin e shitjes përmes kësaj metode. Këto rregulla përcaktojnë të drejtat dhe obligimet se si kategorizohen asetet si “asete me karakter specifik” dhe procedurat lidhur me aplikimin e atyre që kanë të drejtën për blerjen e aseteve me karakter specifik.

PAGESAT E REALIZUARA NGA QEVERIA PËR SHPRONËSIMET E ASETEVE

Janë pagesat e realizuara për asetet që janë shpronësuar nga ana e Qeverisë së Kosovës. Lista detaje e **pagesave gjatë vitit 2018** për asetet e shpronësuar e NSh-ve është si më poshtë:

Ndërmarrjet Shoqërore	PAGESA	Komente
NSh Radio i Televizionit të Prishtinës	80,172	20% e punëtorëve nga vlera e shpronësuar
NSh Bujqësia Fushë-Kosovë	107,207	Pagesa e tërësishme e shpronësimit
NSh Ereniku Prodhimtaria Primare Gjakovë	145,805	Pagesa e tërësishme e shpronësimit
NSh Semafori	591,154	20% e punëtorëve, shumën e kërkesave kreditore të aprovuara nga Autoriteti i Likuidimit sipas raportit të shpërndarjes në vitin 2018 si dhe koston e likuidimit.
GJITHSEJ TË HYRAT NGA SHPRONËSIMET	924,338	

Sa i përket pjesës të mbetur të papaguar të vlerës totale të shpronësimit, për NSh Radio Televizioni i Prishtinës dhe NSh Semafori, në përputhje me nenin 6A, paragrafi 3 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080, AKP mund të kërkojë pjesën tjetër të mjeteve për mbulim të kostove tjera shtesë të tilla si kosto e likuidimit apo vlerën monetare të kërkesave kreditore të nevojshme për shpërndarje qoftë me vendim të Autoritetit të Likuidimit apo me vendime të Gjykatës. Gjithashtu, institucionet përkatëse kanë nënshkruar *letër zotimet* për pagesat e nevojshme që mund të rrjedhin në të ardhmen sipas kërkesave të AKP-së.

TË HYRA NGA BARTJA E SË DREJTËS BANESORE janë pagesat nga bartja e të drejtës banesore të Ndërmarrjeve Shoqërore. Këto pagesa realizohen në përputhje me Ligjin nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave dhe Ligjin nr. 04/L-247 për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-061.

2. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË

AKP deri më tani ka aplikuar dy mënyra të dhënies të aseteve me qira: qiratë nga NSh-të në tranzicion/ likuidim si dhe qiratë e komercializimit gjatë periudhës të tranzicionit të NSh-ve.

Gjithsej inkasimet e qirasë nga **viti 2003 deri më 31 dhjetor 2018** janë si më poshtë:

LLOJET E QIRAVE	SHUMA
Qiratë e NSh-ve në komercializim	5,021,319
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në tranzicion	13,512,812
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në likuidim	20,296,534
GJITHSEJ	38,830,665

2.1. QIRATË E KOMERCIALIZIMIT

Në këtë pozicion janë të paraqitura bilancet e pranimeve për kontratat e komercializimit të nënshkruara gjatë vitit 2000 nga UNMIK. Vlera e tërësishme e inkasimeve, nga viti 2003 deri në datën raportuese është **EUR 5,021,319**.

Nga data 16 qershor 2012, AKP-ja nuk ka realizuar qira përmes metodës të komercializimit, sepse këto asete të NSh-ve ose janë shitur ose janë në proces të likuidimit.

2.2. QIRATË E NSh-ve NË TRANZISION DHE LIKUIDIM

Paraqesin bilancet e pranimeve nga qiramarrësit në llogaritë bankare të NSh-ve përkatëse, llogari të cilat AKP i menaxhon dhe administron. Në përgjithësi, dhënia e aseteve me qira për këto NSh janë: lokalet, toka bujqësore, pikat e shitjes të derivateve, depot dhe të tjera.

Sa i përket inkasimit të qirave për periudhën raportuese, të dhënat përmblledhëse janë si më poshtë:

TABELA A2 - PASQYRA E INKASIMIT TË QIRAVE DHE KRAHASIMI NDËRMJET PERIUDHAVE 2018-2016

	JANAR DHJETOR		JANAR DHJETOR	2017 vs 2016	JANAR DHJETOR
PËRSHKRIMI	2018	2018 vs 2017	2017		2016
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në likuidim	4,658,898	(11)%	5,262,421	1%	5,226,852
Qiratë në llogaritë e NSh-ve në tranzicion	1,609,116	27%	1,265,776	39%	910,718
GJITHSEJ BILANCI I PRANIMEVE	6,268,014	(4)%	6,528,197	6%	6,137,570
		(4%)			

Imapkt kryesor në rënien e inkasimeve ka NSh Pallati i cili nuk është më nën administrim të AKP-së. Kjo ndërmarrje, sipas Ligjit tani është Ndërmarrje Publike dhe nga data 11 shtator 2018 është nën kompetencën e Komunës të Prishtinës.

Nëse nuk llogarisim inkasimin e qirave të NSh Pallati, atëherë niveli i inkasimeve për vitin 2018 është me rritje prej 8.66% në krahasim me vitin 2017.

Gjithashtu, në tabelat e mëposhtme janë paraqitur inkasimet e qirave për NSh-të që kanë vazhduar aktivitetet edhe pas hyrjes në likuidim (tabela A2.1) si dhe NSh-të në tranzicion (tabela A2.2) që kanë nivel të lartë të inkasimeve në periudhën raportuese.

2.2.1. NDËRMARRJET SHOQËRORE NË LIKUIDIM

TABELA A2.1 - PASQYRA E INKASIMIT TË QIRAVE DHE KRAHASIMI NDËRMJET PERIUDHAVE 2018-2016

	JANAR DHJETOR		JANAR DHJETOR		JANAR DHJETOR
	2018	2018 vs 2017	2017	2017 vs 2016	2016
PËRSHKRIMI					
*Grand Hoteli	484,223	14%	425,509	(1)%	431,617
*Pallati i Rinisë, Kulturës dhe Sporteve	883,679	(44)%	1,572,808	51%	1,039,325
Tregu – Prishtinë	860,467	2%	845,568	30%	651,978
ABC Genci	152,531	(15)%	178,922	54%	116,364
NSh tjera në likuidim	2,277,998	2%	2,239,614	(25)%	2,987,568
GJITHSEJ	4,658,898	(11)%	5,262,421	1%	5,226,852
		11%			

*NSh Grand Hoteli ka hyrë në likuidim në Shkurt të vitit 2015, ndërsa NSh Pallati ka hyrë në likuidim në Prill 2016.

Ashtu siç është pasqyruar në shënimet e mësipërme si dhe në tabelat A2 dhe A2.1, largimi i NSh Pallati nga administrimi i AKP-së, ka ndikuar në zvogëlimin e të hyrave të qirasë në raport me vitet paraprake. Sipas Ligjit, kjo ndërmarrje tani është Ndërmarrje Publike dhe nga data 11 shtator 2018 është nën kompetencën e Komunës të Prishtinës.

Ndërsa sa i përket NSh ABC Genci, viti 2018 me performancë të nivelit të inkasimit prej 15% më pak në krahasim me vitin 2017 është si rezultat i inkasimit të borxheve të vitit 2016. Këto borxhe janë inkasime të realizuara në vitin 2017, prandaj paraqitet ky nivel më i lartë i inkasimeve kundrejt vitit 2018.

Nëse nuk llogarisim inkasimin e qirave të NSh Pallati, atëherë niveli i inkasimeve për vitin 2018 është me rritje prej 2% në krahasim me vitin 2017. Ky krahasim është vetëm për llogaritë e NSh-ve në likuidim, meqenëse në nivel të përgjithshëm të inkasimeve (duke përfshirë edhe llogaritë e tranzicionit), rritja e inkasimeve pa përfshirë NSh Pallati është 8.66%, përkthyer në vlerë monetare prej EUR 428,946.

2.2.2. NDËRMARRJET SHOQËRORE NË TRANZICION

TABELA A2.2 - PASQYRA E INKASIMIT TË QIRAVE DHE KRAHASIMI NDËRMJET PERIUDHAVE 2018-2016

	JANAR DHJETOR	2018 vs 2017	JANAR DHJETOR	2017 vs 2016	JANAR DHJETOR
	2018	27%	2017	39%	2016
PËRSHKRIMI					
NSh Jugopetrol	650,616	42%	457,121	29%	355,559
NSh Virxhinia	30,187	100%	112	100%	-
NSh Treska	13,680	(39)%	22,510	50%	15,050
NSh Ina Trgovina	835,624	27%	656,957	36%	482,527
Invest Banka	1,073	(98)%	51,522	100%	0.00
Radio Televizioni i Prishtinës	64,376	3%	62,771	100%	0.00
NSh tjera në tranzicion	13,560	(9)%	14,783	(74)%	57,582
GJITHSEJ	1,609,116	27%	1,265,776	39%	910,718

Impakt kryesor në rritjen e performancës të inkasimit të qirave në krahasim me vitin 2017, siç shihet në **tabelën A2.2** është NSh Jugopetrol, NSh Virxhinia dhe NSh Ina Trgovina.

Ndërsa sa i përket performancës të ulët, të paraqitur në tabelën e mësipërme për NSh Invest Banka, kjo NSh ka hyrë në likuidim më datën 12 shkurt 2018. Pas hyrjes në likuidim, në përputhje me ligjin dhe procedurat bankare të AKP-së, hapet llogaria e likuidimit, në të cilën transferohen dhe menaxhohen të gjitha aktivitetet financiare për NSh-të përkatëse. Në llogari të likuidimit gjatë vitit 2018 janë inkasuar gjithsej EUR 11,807. Gjithashtu, në anën tjetër, dallimi në krahasim me vitin 2017 është si rezultat i pranimet të pagesave të realizuara sipas skemës të “ri-programimit” për borxhet e tre viteve paraprake (inkasuar në vitin 2017). Prandaj paraqitet ky nivel i lartë i inkasimit të qirave për vitin 2017 kundrejt vitit 2018. Në vitin 2018, vijojnë pagesat e qirave në mënyrë të rregullt.

E njëjta vlerën edhe për NSh Treska, gjatë vitit 2017 kemi të hyra më të mëdha të inkasimit si rezultat i “ri-programimit të borxhit” dhe marrëveshjes që të paguaj borxhin paraprak në mënyrë që të hyjë në kontratë të qiradhënies

3. INTERESI I FITUAR

Të hyrat nga interesi janë:

- **Interesit nga Llogaritë Rrjedhëse** - Nga Korriku i vitit 2012, nuk kemi të hyra nga interesi në **llogaritë rrjedhëse** në Bankën Qendrore të Kosovës. Kjo për shkak se nga ajo periudhë norma e aplikuar e interesit nga BQK është **zero %**;
- **Interesit i fituar nga Depozitat Kohor** - Nga Korriku i vitit 2015, nuk kemi të hyra nga interesi nga afatizimi (BQK dhe bankat komerciale) i fondeve në mirëbesim për periodat nga 1 muaj deri në 12 muaj.

Gjithsej interesi i përgjithshëm i fituar nga viti 2003 deri në datën raportuese është **EUR 34,844,700** në të gjitha llogaritë bankare të hapura në BQK. **Për vitin fiskal 2018, nuk ka pasur të hyra nga interesi për shkak të normave të interesit të cilat nuk janë pozitive.**

Me ndryshim/plotësimin e Ligjit nr. 06/L-023 të datës 3 maj 2018 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është paraparë që të gjitha të ardhurat e mbledhura nga Agjencia dhe të cilat mbahen në mirëbesim mund të investohen në instrumentet në vijim:

- Llogari rrjedhëse që paguan interes apo depozitë të afatizuar në Bankën Qendrore të Kosovës; dhe
- Letra me vlerë të borxhit të emetuara nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Kosovës ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Mirëpo, mundësitë që të bëhen investime të mëdha në tregjet e parasë dhe të kapitalit sipas nenit 19B të Ligjit nr. 06/L-023 dhe nenit 18.3 të Ligjit bazik nr. 04/L-034, janë të kufizuara si rrjedhojë e dy situatave të mëposhtme:

1. **Normave të ulëta të interesit.**
 - 1.1. Banka Qendrore në 4 vitet e fundit nuk ka ofertuar fare interes për afatizime të mjeteve dhe nga viti 2012 nuk paguan interes në llogaritë rrjedhëse. E njëjta vlen dhe për bankat komerciale (ato që plotësojnë kushtet) nuk shprehin interes që AKP-së t'i japin mundësi që të afatizoj mjetet në depozita kohor;
 - 1.2. Letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria. Sipas rregullores për emetimin e letrave me vlerë të Qeverisë, deri më tani kemi pasur kufizime për pjesëmarrje në këto tregje. Kufizimet ka qenë të llojit të pjesëmarrjes nëpërmjet Agjentëve (akteve primar) dhe shitblerjes të tyre në tregjet sekondare, që për Agjencinë nuk kanë qenë të favorshme, meqenëse ofroreshin norma të ulëta të interesit.
2. **Burime të kufizuara të fondeve për shkak të Fondeve të përkohshme dhe fondeve të mbetura.** Vetëm gjatë vitit 2018 janë transferuar gjithsej EUR 86,146,458 si fonde të mbetura dhe të përkohshme në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Ndërsa në vitin 2019 janë parashikuar që të transferohen fonde të përkohshme dhe Fondet e mbetura në Buxhetin e Kosovës në përputhje me nenin 4, paragrafi 3.2.6 dhe 3.2.7 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080.

4. TARIFA PËR PJSËMARRJE NË TENDERËT E SHITJES DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE

Janë të hyra të realizuara për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Këto të hyra përfshijnë të hyra nga **tarifat për paraqitjen e tenderëve dhe konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve**, të cilët nuk i kanë përmbushur kushtet e pagesës. Këto të hyra gjenerohen në llogaritë bankare, të cilat AKP, më përpara i ka hapur për qëllime të mbarëvajtjes të aktiviteteve operacionale dhe procedurale. Llogaritë janë si më poshtë:

- Tarifa për dorëzimin e ofertave të privatizimit;
- Tarifa për dorëzimin e ofertave të likuidimit; dhe
- Fondi Rezervë i AKP-së;

Bilancet e pranimeve dhe pagesave për periudhën janar – dhjetor 2018 janë paraqitur sipas tabelës të mëposhtme:

TABELA A4 - PASQYRA E TARIFËS PËR PJSËMARRJE NË TENDER DHE KONFISKIMIN E BID DEPOZITAVE

PËRSHKRIMI I LLOJEVE TË TRANSAKSIONEVE	RENDITJA	SHUMA
Bilanci bankar deri më 31 Dhjetor 2017	1	8,229,964
Anulimi i vendimit dhe kthimi i Bid Depozitit të konfiskuar në vitin 2017	2	(40,000)
Tarifa për pjesëmarrje në tender 2018	3	108,300
Kthimet e tarifës administrative/anulim tenderi apo raste tjera 2018	4	(5,400)
Konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve që nuk kanë plotësuar kushtet	5	27,000
Bilancet i pranimeve dhe pagesave për periudhën janar – dhjetor 2018	6=Σ(2:5)	89,900
GJITHSEJ BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE	7=1+6	8,319,864

5. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER

Janë të hyra nga BID depozitat e ofertuesve që kanë marrë pjesë në tender dhe për të cilët ende nuk ka përfunduar procesi i shitjes. Me përfundim të procesit të shitjes, bilanci bankar do të jetë zero, sepse me nënshkrimin e kontratave, këto mjete si BID depozita, si pjesë e vlerës së blerjes, transferohen në llogari të NSh-ve përkatëse, për të cilat janë shituar asetet. Këto të hyra gjenerohen në llogaritë bankare, të cilat AKP, më përpara i ka hapur për qëllime të mbarëvajtjes të aktiviteteve operacionale dhe procedurale. Llogaritë janë si më poshtë:

- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të privatizimit;
- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të likuidimit;

Bilancet e pranimeve dhe pagesave për periudhën janar – dhjetor 2018 janë paraqitur sipas tabelës të mëposhtme:

TABELA A5 - PASQYRA E LLOGARISË TË BID DEPOZITAVE PËR PJESËMARRJE NË TENDER

PËRSHKRIMI I LLOJEVE TË TRANSAKSIONEVE	RENDITJA	SHUMA
Bilanci bankar i llogarive për pjesëmarrje të tenderëve deri më 31 Dhjetor 2017	1	2,030,820
BID Depozitat e paguara nga ofertuesit për pjesëmarrje në tender	2	4,769,852
Kthimi i BID Depozitave ndaj Ofertuesve të pasukseshëm	3	(4,120,168)
Bartje e BID depozitave pas nënshkrimit të kontratave në llogaritë e NSh-ve	4	(1,850,304)
*Anulimi i tenderëve të shitjes/kthimi i Bid Depozitit të konfiskuar në vitin 2017	5	40,000
*Konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve që nuk kanë përmbushur kushtet	6	(27,000)
Bilanci i pranimeve dhe pagesave për periudhën janar – dhjetor 2018	7=Σ2:6)	(1,187,620)
GJITHSEJ BALANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE DERI ME 31 DHJETOR 2018	8=1+7	843,200

* Janë paraqitur në tabelën nr.A4 në shënimin shpjegues nr. 4.

6. TË HYRAT E TJERA

Janë të hyrat të cilat janë realizuar në llogaritë e NSh-ve në tranzicion, NSh-ve në likuidim, Donatorëve dhe të tjerë në vlerën prej **EUR 7,263,974**. Kjo vlerë paraqet inkasimin e mjeteve nga viti 2003 – 31 dhjetor 2018.

Të hyra janë si më poshtë:

- Shitja e mallrave dhe shërbimeve;
- Dividenta dhe shitja e aksioneve;
- Transferimi i mjeteve nga llogaritë bankare të NSh-ve të cilat kanë qenë aktive dhe kanë pasur mjete në llogaritë e bankave komerciale;
- NSh-të e paraqitur si kreditor për pretendimet e saj (Debitorët e NSh-ve).

TABELA A6 - PASQYRA E TË HYRAVE TJERA TË REALIZUARA NË TË MIRË LLOGARIVE TË NSh-ve

PËRSHKRIMI I LLOJEVE TË TRANSAKSIONEVE	RENDITJA	SHUMA
Bilanci bankar i të hyrave të tjera më 31 Dhjetor 2017	1	6,866,535
Inkasimi i mjeteve nga ndëshkimet financiare për Spin Off-et.	2	29,500
Inkasimet ditore në para të gatshme nga aktiviteti për NSh Tregu	3	15,022
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSh ABC Genci	4	31,826
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSh Grand Hotel	5	37,080
Pranimet nga debitorët e NSh-ve	6	88,174
Të hyra të tjera në llogaritë e NSh-ve	7	818
Pranimi i mjeteve nga llogaritë në bankat komerciale	8	195,019
Bilanci i pranimeve dhe pagesave për periudhën janar – dhjetor 2018	9=Σ2:8)	397,439
GJITHSEJ BALANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE	10=1+9	7,263,974

SHPJEGIM PËR TË HYRAT TJERA

1. **Inkasimet ditore në para** të gatshme në të mirë të llogarive të NSh-ve përkatëse kanë të bëjnë me mjetet që pranohen gjatë aktivitetit ditor për të hyrat si: bifet, shitja e biletave, shërbimeve apo të tjera tek NSh të tilla si ABC Genci, NSh Grand Hotel si dhe NSh Tregu. Këto NSh janë në likuidim, llogaritë e të cilave i menaxhon dhe administron AKP;
2. **Mjeteve të pranuar nga llogaritë në bankat komerciale** aty përfshihet dhe shuma prej EUR 191,041.92 e NSh në likuidim "Sharr Hani i Elezit". Këto mjete të kësaj NSh-je, gjatë 2018-së janë bartur në llogarinë përkatëse të NSh-së në likuidim. Në përputhje me Ligjin dhe procedurat bankare të AKP-së, të gjitha mjetet nga të gjitha llogaritë bankare që ka pasur NSh-ja, barten në një llogari bankare të likuidimit e cila hapet dhe mirëmbahet në Bankën Qendrore të Kosovës.
3. **Sa i përket inkasimeve të mjeteve prej EUR 29,500** nga ndëshkimet financiare për Spin Off-et, janë mjete të inkasuara të cilat në pasqyrat financiare 2017 janë paraqitur në llogaritë e arkëtueshme për NSh IDGJ Tobacco. Për me tepër referoju dhe **shënimin shpjegues nr. 18**.
4. **Pranimet nga debitorët e NSh-ve** – NSh që përfitojnë nga procesi i shpërndarjes të kreditorëve. Në këtë rast, gjendja e përgjithshme e fondeve në mirëbesim nuk ndryshon për shkak se janë transaksione ndërmjet llogarive të NSh-ve të cilat AKP i administron. Pra në njërin anë kemi shpërndarje të mjeteve që reflektojnë në kategorinë e kreditorëve dhe në anën tjetër kemi të hyra në llogaritë e NSh-ve tjera që kanë përfituar nga ky proces i shpërndarjes.

7. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit nr. 04/L-034, Agjencia ka hapur llogarinë bankare të kapitalit themeltar. Gjithsej vlera e kapitalit themeltar është EUR 10 milion, ndërsa shuma e transferuar nga Qeveria është EUR 1 milion. Pjesa e mbetur prej EUR 9 milion mund të kërkohet nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së në kohën dhe në shumën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë.

Gjithsesi, më poshtë është paraqitur një raport lidhur me pranime dhe pagesat nga llogaria e kapitalit themeltar.

TABELA A7 - PASQYRA E LLOGARISË BANKARE TË KAPITALIT THEMELTAR

PËRSHKRIMI I LLOJEVE TË TRANSAKSIONEVE	RENDITJA	SHUMA
Gjendja bankare deri me 31 dhjetor 2017	1	1,109,549
Të hyra të realizuara në llogari të kapitalit themeltar	2	-
Pagesat e vendimeve të Gjykatës <i>Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 13</i>	3	(60,687)
Tarifa bankare për ekzekutim të pagesave	4	(1.30)
Bilanci i pranimeve dhe pagesave për periudhën janar – dhjetor 2018	5=Σ(2:4)	(60,688)
GJITHSEJ BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE ME 31 DHJETOR 2018	6=1+5	1,048,861

Ndërsa, më poshtë janë të paraqitura detajet e kapitalit themeltar për të gjitha transaksionet nga viti 2003 deri në datën raportuese:

- **Të hyrat në llogarinë e kapitalit prej EUR 1,132,172**
 - Të hyra nga pagesa e kapitalit themeltar prej EUR 1,013,200. Pagesa është realizuar nga Qeveria e Kosovës;
 - Të hyrat nga interesi prej EUR 118,972. *Janë shpalosur në shënimit shpjegues nr. 3.*
- **Pagesat nga llogaria e kapitalit prej EUR 83,311**
 - Pagesat e vendimeve të Gjykatave prej EUR 83,303. *Janë shpalosur në shënimin shpjegues nr. 13.*
 - Shpenzimet bankare prej EUR 8.00. *Janë shpalosur në shënimin shpjegues nr. 15*
- **Gjendja bankare në fund të periudhës 1,048,861.05**

SHPENZIMET/SHPËRNDARJA

8. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK

Nga viti 2003 deri në periudhën raportuese, shuma e transferuar e 20% për punëtorët e NSh-ve në llogarinë e BSPK-së është **EUR 126,227,784** nga 314 Ndërmarrje Shoqërore.

Ndërsa vetëm për periudhën raportuese, gjithsej bilanci i pagesave në të mirë të llogarisë bankare të BSPK-së është **EUR 6,970,480** dhe atë nga llogaritë bankare të 73 Ndërmarrjeve Shoqërore.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pagesat sipas llojit të llogarive bankare:

TABELA A8 - PASQYRA E BILANCIT TË PAGESAVE NDAJ BSPK-SË

PËRSHKRIMI I LLOJEVE TË TRANSAKSIONEVE	RENDITJA	SHUMA
Gjendja e pagesave në BSPK deri me 31 dhjetor 2017	1	119,257,304
Llogaritë e Privatizimit nga shitjet mëhershme të Ndërmarrjeve të Reja	2	99,588
Llogaritë e Likuidimit - Shitjet e aseteve përmes procesit të likuidimit	3	4,242,559
Llogaritë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve	4	2,628,333
Bilani i pagesave ndaj BSPK-së për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2018	5=Σ(2:4)	6,970,480
GJITHSEJ BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE ME 31 DHJETOR 2018	6=1+5	126,227,784

SHPJEGIM PËR SHPËRNDARJEN E MJETEVE NË BSPK

Agjencia Kosovare e Privatizimit, mjetet e 20% të punëtorëve i transferon në llogarinë bankare të BSPK-së. BSPK, pastaj bënë shpërndarjen sipas listës të aprovuar të 20% të punëtorëve. Për rastet që ka ankesa, mbahen në llogari të fondeve në mirëbesim të cila i administron AKP-ja. Këto mjete mbahen në mirëbesim në llogaritë bankare të hapur eksklusivisht vetëm për këto raste për secilën NSh.

Gjendja bankare që mbahet në mirëbesim deri në zgjidhjen e këtyre kontestet gjyqësore është EUR 13,208,013

Për periudhën raportuese, numri i punëtorëve që kanë përfituar nga 20% është 11,547. Ndërsa, numri i përgjithshëm i punëtorëve që kanë përfituar nga shpërndarja e 20% për periudhën 2003-2018 është 47,481.

Nga bilancet e pageave të AKP-së (hyrje/dalje) për në llogari të BSPK-së, mjete të pa shpërndara nga ana e BSPK-së për në llogari të punëtorëve kanë mbetur prej EUR 322,881 sipas shënimeve të përcjellura nga Njësia e 20% të Punëtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Këto shënime janë sipas transaksioneve deri më 31 dhjetor 2018.

9. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSHP)

Më 11 korrik 2012 është kontraktuar kompania për Ofruesin e Shërbimeve Profesionale mes AKP-së dhe “Deloitte Central Europe Limited” si pjesë e Autoritetit të Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Sipas **kontratës bazë** janë dy lloje të pagesave: fikse (kuartale) dhe variabile. Vlera e tërësishme e pagesave sipas kontratës bazë është **EUR 14,008,930**. Kjo kontratë ka përfunduar më datën 9 korrik 2016

Aneks kontrata me “Deloitte Central Europe Limited” dhe AKP-në është lidhur me 8 gusht 2016. Shërbimet e kontraktuara sipas kësaj aneks kontrate kanë përfunduar me 7 gusht të vitit 2018. Vlera e tërësishme e kontratës dhe pagesave të realizuara për periudhat e angazhuara është **EUR 1,992,000**.

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e kontraktuara të kontratës bazë dhe aneks kontratës si dhe të gjitha pagesat e realizuara nga viti 2012 deri më 31 dhjetor 2018.

PËRSHKRIMI	KONTRATA	PAGESAT	DIFERENCA	%
Kontrata e parë bazë - kostoja fikse	4,924,740	4,924,740	0.00	100
Kontrata e parë bazë - kostoja variabile	13,003,564	9,084,190	3,919,374	70%
Aneks kontrata 10% e vlerës të kontratës bazë	1,992,000	1,992,000	0.00	100%
GJITHSEJ	19,920,304	16,000,930	3,919,374	80%

DIFERENCA TEK KONTRATA BAZË nuk paraqet obligim, por është vetëm pasqyrim i gjendjes të pagesave kundrejt vlerës të kontraktuar.

Sa i përket periudhës raportuese, **pagesat e realizuara janë gjithsej EUR 581,000**. Më poshtë janë paraqitur të gjitha pagesat e realizuara ndër-vite:

VITET	KONTRATA BAZË		ANEKS KONTRATA FIKSE	GJITHSEJ
	FIKSE	VARIABILE		
2012	1,228,009	-	-	1,228,009
2013	1,228,009	2,781,117	-	4,009,126
2014	491,204	3,277,988	-	3,769,192
2015	245,602	1,458,973	-	1,704,575
2016	1,731,916	1,566,112	415,000	3,713,028
2017	-	-	996,000	996,000
2018	-	-	581,000	581,000
GJITHSEJ	4,924,740	9,084,190	1,992,000	16,000,930

SHPJEGIM PËR ANEKS KONTRATËN TË KONTRATËS BAZË

Më datën 8 Gusht 2016 është nënshkruar kontrata e re si aneks i kontratës bazë në vlerën prej 10%. Vlera totale e kontraktuar është EUR 1,992,000. Sipas aneks kontratës, në periudha mujore janë realizuar pagesat prej EUR 83,000 për 24 periudha.

GARANCIONI BANKAR Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar një garancion bankar lidhur me performancën e aneks të kontratës nga Deloitte Central Europe Limited për Ofrimin e Shërbimeve Profesionale për likuidimin e portfolios së NSH-ve (nr. i prokurimit 239-11-068-211). Detajet e garancionit bankar janë si vijon: data e garancionit 21 Shtator 2016, shuma e garancionit 199,200.00, emri i bankës që ka lëshuar garancionin: ING Bank N.V. PO BOx 350, 1000 Amsterdam, The Netherlands.

Shënim lidhur me pagesat e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OSHP):

Në bazë të nenit 20 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115, me Ligjin nr. 05/L-080 dhe me vendim të Bordit të Drejtorëve:

- a) *Tarifa fikse e Autoritetit të Likuidimit paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin e caktimit të saktë të kostos fikse proporcionalisht për secilën ndërmarrje shoqërore në likuidim, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria bankare e ndërmarrjes në likuidim;*
- b) *Tarifa variable (për kërkesat e shqyrtuara) e Autoritetit të Likuidimit dhe kostot tjera të paraqitura në kostot 1.1 dhe 1.3 të nenit 40.1 të shtojcës së ligjit nr. 04/L-034 paguhet nga fondet e ndërmarrjes në likuidim. Në rast se ende nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit, atëherë tarifa variable paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.*

Po në bazë të këtij neni, sipas plotësim/ndryshim të Ligjit nr. 06/L-023, të aprovuar në muajin maj 2018, tani më specifikohet qartazi rreth mënyrës të pagesave ndaj OSHP-së dhe kostove të likuidimit dhe se adresimi i çështjes në raportet e mëparshme të auditorëve nga Zyra Kombëtare e Auditimit tani më është sqaruar.

10. MALLRA DHE SHËRBIME

Në përgjithësi në këtë kategori përfshihen pagesat për: ofruesve e shërbimeve për NSh në Likuidim dhe Pagat e Punëtorëve – NSh në tranzicion; qiraja, shpenzime për reklamim, shërbime profesionale dhe mirëmbajtja dhe ruajtja e aseteve.

Për periudhën raportuese, vlera e tërësishme e bilancit të pagesave është prej EUR 1,941,882 dhe atë:

PËRSHKRIMI	SHUMA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	1,954,997
Kompenzimi nga NSh në llogarinë e tarifës administrative	(13,115)
GJITHSEJ	1,941,882

KOMPENZIMI NGA NSh-të NË LLOGARINË E TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 13,115 paraqitet si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndërsa në anën tjetër është paraqitur si shpenzim (plus) në kategorinë e shërbimeve publike, taksave gjyqësore etj. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse dhe pastaj kjo llogari kompensohet nga llogaritë e NSh-ve në likuidim dhe NSh-ve në tranzicion.

Ndërsa sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim **ndaj palëve të jashtme**, ato janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Këto pagesa janë realizuar nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion, likuidim dhe tarifa administrative e Agjencisë.

PËRSHKRIMI	SHUMA
Ofruesit e Shërbimeve dhe pagat e punëtorëve (MIM Golesh) – <i>shih shënimin 10.1</i>	701,786
Ofruesit e Shërbimeve për NSh-të Grand Hotel, Pallati, ABC Genci dhe Tregu – <i>shih shënimin 10.1</i>	933,417
Shërbime për mirëmbajtje dhe ruajtje të aseteve me operatorët ekonomik	40,596
Shërbime profesionale-Angazhimi i përmbauesve/përfaqësime ligjore dhe ekspertizë ligjore	33,106
Qiraja e paguar nga NSh Tregu (për hapësirat e përbashkëta) dhe buxheti i AKP-së për Grand Hotel	36,554
Furnizim me material higjienik, administrative dhe bifesë për Grandin, Pallatin dhe ABC Genci	13,689
Pagesat për marrëveshjet e kontraktuara të filmave për ABC Genci në likuidim	15,433
Ngrohje qendrore për NSh Grand Hotel dhe Pallati në likuidim	90,911
Shpenzime të marketingut, mirëmbajtje të uebsajtit, rryma, taksa gjyqë/kadastrale dhe tjera	5,807
Shpallje në gazeta vendore dhe ndërkombëtare	16,982
Dërgesa postare	7,101
Tatimet dhe Trustet Pensionale për OSh-të nga tarifa për NSh-të përkatëse	21,491
Pagesa e urdhrat përmbarimor	116
Shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit (përfaqësime në Gjykatë në Mal të Zi)	11,820
Shpenzimet nga paraja e imët për Zyrat Regjionale	23,038
Provizione për ruajtjen e artikujve në Bankën Qendrore të Kosovës	3,150
GJITHSEJ	1,954,997

Nivelin më të lartë të pagesave të realizuara kundrejt **totalit** për mallra dhe shërbime e kanë Ofruesit e Shërbimeve prej **83.64%** ndërsa me radhë janë shpenzimet për ngrohje qendrore prej **EUR 4.65%**.

RAPORT I PARASË SË IMËT DHE AVANSIT PËR UDHËTIME ZYRTARE NGA LLOGARIA E TARIFËS ADMINISTRATIVE

Zyra Regjionale	Shuma e Avansit	Shpenzimi	Kthimi i mjeteve
ZR e Pejes	4,000	3,823.75	176.25
ZR e Prishtines	5,000	4,614.99	385.01
ZR e Gjilanit	6,000	4,467.40	1,532.60
ZR e Mitrovices	5,000	3,891.74	442.64
ZR e Prizrenit	5,500	5,453.76	46.24
Për qëllime të privaitizimit	2,400	786.10	1,613.90
*GJITHSEJ – PARAJA E IMËT	27,900	23,037.74	4,196.64
**AVANS PËR UDHËTIME ZYRTARE	12,750	11,820.35	929.65

*Paraja e imët e dhënë në avans ka të bëjë me shpenzimet e vogla për Zyrat Rajonale për NSh-të përkatëse. Avanset tërhiqen nga llogaria e tarifës administrative në fillim të vitit dhe sipas kërkesave shtesë nga ZR-të. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të vogla të tilla si taksa gjyqësore, taksa për certifikata të pronësisë, shpenzime të nevojshme të vogla për mirëmbajtjen e aseteve dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të NSh-ve në likuidim.

**Paraja e imët e dhënë në avanset për udhëtime zyrtare kanë të bëjnë me shpenzimet jashtë vendit. Këto shpenzime janë për përfaqësime në Gjykata për mbrojtjen e aseteve që gjenden jashtë vendit. Të gjitha procedurat dhe zbatueshmëria e rregullave mbështetet sipas rregullave të Ministrisë së Financave për udhëtimet zyrtare jashtë vendit.

10.1 PAGESAT NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

Angazhimi i ofruesve të shërbimeve bëhet në përputhje me procedurat të aprovuar nga Menaxhmenti i AKP-së. Përveç procedurave, për rastet e NSh-ve në likuidim, këto shpenzime janë të lejuara sipas kornizës buxhetore të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve. Korniza buxhetore, sipas planit kontabël përfshinë 29 lloje të shpenzimeve të fondeve në mirëbesim, brenda të cilave është edhe angazhimi i ofruesve të shërbimeve. Gjithsesi, vlen të theksohet se përveç kornizës buxhetore të llojeve të shpenzimeve të lejuara, me aprovim të Bordit caktohet edhe kufiri maksimal i shumës së buxhetuar për shpenzim për 29 kode gjithsej.

Sipas procedurës, për të angazhuar Ofrues të Shërbimeve për NSh përkatëse, përparësi kanë ish-punëtorët e atyre Ndërmarrjeve Shoqërore.

Angazhimi i ofruesve të shërbimeve kryesisht bëhet për: **arkivat dhe grumbullimin e dokumentacionit për listat e 20%-it të punëtorëve, kërkesat e kreditorëve, asistencë në identifikimin e aseteve, ruajtjen e aseteve dhe rastet tjera**. Gjithashtu, angazhimi i ofruesve të shërbimeve është për mbarëvajtjen e punës për NSh-të e mëdha/komplekse të cilat kanë vazhduar aktivitetin e tyre pas hyrjes në likuidim të tilla si: Pallati, Grandi, ABC Genci, dhe Tregu. Gjithashtu në NSh MIM Golesh dhe NSh Virxhinia ka punëtorë të angazhuar.

Pjesën më të madhe të shpenzimeve nga angazhimi i OSh-ve si roje apo për shërbime tjera e përbëjnë NSh-të e mëdha që kanë pasur aktivitete të tilla si NSh Grand Hotel, NSh Pallati, NSh ABC Genci si dhe NSh Tregu. Për NSh Pallati kemi paguar Osh-të për periudhën deri më 31 gusht 2018, meqenëse nga data 11 shtator 2018 kjo NSh tani është nën kompetencën e Komunës të Prishtinës.

Më poshtë i paraqesim përmbledhjen e pagesave për OSh-të që janë angazhuar si roje, për shërbime tjera si dhe pagat e punëtorëve të NSh-ve (NSh operative dhe NSh tjera) që janë në tranzicion dhe kanë menaxhmentin aktiv të tilla si NSh MIM Golesh dhe NSh Virxhinia.

PËRSHKRIMI	Shuma për roje	Shuma shërbime tjera	GJITHSEJ
Pagesat ndaj OSh-ve të angazhuar për NSh-të operative	268,828	664,589	933,417
Pagesat ndaj OSh-ve të angazhuar për NSh-të tjera	305,205	169,943	475,148
Paga të punëtorëve për NSh-të në tranzicion	-	226,638	226,638
GJITHSEJ	574,033	1,061,170	1,635,203

Sa i përket Osh-ve të angazhuar si roje në të gjitha NSh-të, nga viti 2016, si pjesë strategjike e menaxhmentit të AKP-së është paraparë që ruajtja e aseteve të bëhet nëpërmjet angazhimit të Osh-ve dhe jo nëpërmjet operatorëve ekonomik. Ky veprim ka rezultuar me efekt pozitiv në kursimet e mëdha buxhetore për NSh-të përkatëse krahasuar me periudhat e mëhershme.

Nëpërmjet tabelës të mëposhtme, janë paraqitur detajet e angazhimit të Ofruesve të Shërbimeve për secilën NSh. *Shih në faqen vijuese.*

NDËRMARRJET SHOQËRORE	PERIUDHA E ANGAZHIMIT	Nurmi i OSh-ve	SHUMA
MIM Golesh	janar – dhjetor 2018	45	201,797
NSh Virxhinia	Dhjetor 2017 – dhjetor 2018	19	24,841
PRN170 Jugopetrol	1 dhjetor 2017 – 31 dhjetor 2018	10	12,947
PRN104 Tregu- likuidim	janar – dhjetor 2018	99	291,972
PRN067 Pallat- Likuidim	janar – 31 gusht 2018	113	338,533
PRN173 Hotel Grand	janar – dhjetor 2018	82	231,371
PRN066 ABC Genci	janar – dhjetor 2018	15	71,541
GJI018 Morava Partesh	1 dhjetor 2017 – 31 dhjetor 2018	4	12,642
GJI023 Zarije Bujic	1 dhjetor 2017 – 31 dhjetor 2018	4	12,736
GJI063 Lola Shterpce	janar – dhjetor 2018	8	23,238
GJI064 FAM VITI	1 dhjetor 2017 – 2 dhjetor 2018	4	12,797
GJI093 Hotel Junior Brezovica	1 dhjetor 2017 – 31 dhjetor 2018	4	12,587
GJI170 Xim Strezovci	nëntor 2016 – dhjetor 2017	8	23,141
MIT044 Transkosova	1 dhjetor 2017 – 31 dhjetor 2018	4	12,361
PEJ020 Strellci Deçan	23-29 dhjetor 2018	4	271
PEJ089 Ramiz Sadiku	Janar – prill 2018	4	3,873
PRN006 Shpezëtaria	1 dhjetor 2017 – 31 dhjetor 2018	4	12,587
PRN029 IMN Kosova	janar – dhjetor 2018	10	35,545
PRN030 Izolimi	15 dhjetor 2017 – 15 janar 2018	4	992
PRN075 Rilindja Shtypshkronja	janar – dhjetor 2018	17	44,908
PRN035 Ramiz Sadiku	1 dhjetor 2017 – 31 janar 2018	2	7,861
PRN093 Gërmia	1 dhjetor 2017 – 31 dhjetor 2018	7	11,515
PRN111 -Perparimi	janar – dhjetor 2018	11	38,677
PRN125 Bankos	janar – dhjetor 2018	13	40,164
PRN167 Auto Moto e Kosovës	1 dhjetor 2017 – 31 janar 2018	4	2,303
PRZ009 Lavertari Blegtori	1 nëntor 2017 – 31 dhjetor 2018	5	18,424
PRZ014 IGK Ballkan	janar – dhjetor 2018	9	27,586
PRZ018 NSh Unimont	janar – dhjetor 2018	4	13,818
GJI111 Shar Drvoexport - Shtërpc	11 janar – 31 dhjetor 2018	5	11,289
Për 30 NSh-të tjera	janar – dhjetor 2018	42	82,886
*Numri i OSh-ve të cilët janë angazhuar në NSh-të e ndryshme		(17)	
GJITHSEJ		547	1,635,203

*Meqenëse numri i OSh-ve është paraqitur sipas NSh-ve përkatëse, atëherë janë gjithsej 17 raste që janë angazhuar nëpër NSh të ndryshme dhe për qëllim të pasqyrit të sakt të numrit total të angazhuar është paraqitur si zbritje.

Sa i përket numrit të OSh-ve të NSh-ve të shënuar më lartë, ky numër ka ndryshuar në periudhat e ndryshme gjatë vitit fiskal 2018, i cili nuk ka tejkaluar numrin e punëtorëve të lartë shënuar.

11. SHËRBIMET PUBLIKE

Kanë të bëjnë me pagesat e realizuara për shërbimet publike (rrymë, ujë, telefoni) për Ndërmarrjet Shoqërore në tranzicion dhe në Likuidim që kanë aktivitete të përditshme.

Bilanci i pagesave për periudhën raportuese është EUR 412,063. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pagesat:

PËRSHKRIMI	SHUMA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	409,970
Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative	2,093
GJITHSEJ	412,063

KOMPENZIMI NGA NSh-të NË LLOGARINË E TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 2,093 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e komunalive ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse.

Ndërsa sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim **ndaj palëve të jashtme**, ato janë paraqitur në tabelën e mëposhtme. Këto pagesa janë realizuar nga llogaritë e NSh-ve në tranzicion dhe likuidim.

LLOJET E PAGESAVE	NSh-TË NË TRANZICION	NSh-TË NË LIKUIDIM	GJITHSEJ
Shpenzime për furnizim me ujë	2,285	21,107	23,392
Shpenzimet për rrymë	10,474	257,589	268,063
Shpenzime për pastrimin e mbeturinave	176	110,868	111,044
Shërbimet e telekomunikimit	341	7,130	7,471
GJITHSEJ PAGESAT	13,276	396,694	409,970

12. TATIMET

Kanë të bëjnë me pagesat e tatimeve për NSh-të në tranzicion dhe ato në likuidim, për të hyrat e inkasuara nga qiraja, TVSh-ja, mbajtja në burim e tatimit në të ardhura personale, kontributet pensionale për OSh-të si dhe tatimin në pronë.

Bilanci i pagesave për periudhën raportuese është EUR 1,122,325. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pagesat:

PËRSHKRIMI	SHUMA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	1,120,840
Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative	1,485
GJITHSEJ	1,122,325

KOMPENZIMI NGA NSh-të NË LLOGARINË E TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 1,485 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e komunalive ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSh-ve përkatëse.

Ndërsa sa i përket shpenzimeve me **palët e jashtme**, ato janë paraqitur si më poshtë:

LLOJET E PAGESAVE	NSh-TË NË TRANZICION	NSh-TË NË LIKUIDIM	GJITHSEJ
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	258,790	560,608	819,398
Tatimi nga të hyrat e relizuara/qiratë	10,317	65,574	75,891
Kontributet pensionale- Trusti	25,696	111,972	137,668
Tatimi në të ardhurat personale	11,082	38,792	49,874
Tatimi në Pronë – Komunave	3,611	34,398	38,009
GJITHSEJ PAGESAT	309,496	811,344	1,120,840

13. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE

Këto pagesa kryesisht kanë të bëjnë me rastet e mëposhtme:

- taksa gjyqësore dhe garancione në Gjykatë; dhe
- vendime të Gjykatave dhe pagesa ndaj përmbauesve.

Bilanci i pagesave për periudhën raportuese është EUR 707,711 dhe atë:

PËRSHKRIMI	SHUMA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	698,063
Kompenzimi i llogarisë të tarifës administrative	9,648
GJITHSEJ	707,711

KOMPENZIMI NGA NSH-të NË LLOGARINË E TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 9,648 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e komunalive ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime kanë ndodhur më parë nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së për shpenzimet e NSH-ve përkatëse.

Ndërsa sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim **ndaj palëve të jashtme**, ato janë paraqitur si më poshtë:

LLOJET E PAGESAVE	SHUMA
Taksa Gjyqësore	8,530
Ekspertizat për Gjykatë	350
*Ekzekutimi i pagesave nga përmbauesi privat për NSH Pallati	628,496
**Ekzekutimi i pagesës ndaj palës me vendim të Gjykatës	60,687
GJITHSEJ PAGESAT	698,063

*Gjatë kësaj periudhe janë ekzekutuar pagesat nga përmbauesi privat nga llogaria e NSH Pallati në likuidim. Këto ekzekutime të pagesave janë në kundërshtim me nenin 10 të shtojcës të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Të gjitha palët, BQK-ja, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe Oda e Përmbauesve janë të njoftuar me ngjarjet në fjalë. Pagesat e ekzekutuara nga përmbauesi privat nga llogaria bankare e NSH Pallati e hapur në BQK dhe e cila ka qenë nën kompetencë të AKP-së, janë **gjithsej** EUR 577,673. Ndërsa nga data 11 shtator 2018, kjo NSH ka kaluar nën kompetencë e komunës të Prishtinës dhe po nga kjo llogari janë ekzekutuar nga i njëjti përmbaues privat shumat prej EUR 50,823. Gjendja e llogarisë bankare në BQK, më 31 dhjetor 2018 është zero. AKP-së nuk i është lejuar që të bëjë mbylljen e kësaj llogarie për shkak se është nën-administrimin e përmbauesve.

Ndërsa sa i përket pagesës prej EUR 60,687 ndaj palës, kjo shumë është ekzekutuar me vendim të Gjykatës me nr. **892-2010. Gjithashtu me qëllim të zbatimit të procedurave për llogaritë bankare të AKP-së, kjo pagesë me aprovim të Bordit të Drejtorëve është lejuar që të ekzekutohet nga llogaria e kapitalit themeltar të AKP-së.

Ky rast ka të bëjë me kompenzimin e mjeteve ndaj palës që kishte marrë pjesë në shitjen e asetit të NSH “Famipa”. Pala kishte paguar mjetet sipas procedurave të shitjes, mirëpo me pastaj Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e kishte pezulluar shitjen. Si rrjedhojë, pala kishte kërkuar që të paguhet mbi dëmin që i ishte shkaktuar me arsyetimin se për mjetet që kishte paguar për blerjen e asetit ka hyrë në obligime (kredi) dhe në këtë rast ishte i dëmtuar, meqenëse ishte anuluar shitja e asetit. Gjithashtu ky shpenzim është shpalosur në *shënimin shpjegues nr. 7*.

14. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-së

Agjencia Kosovare e Privatizimit që nga vitit 2011 e deri më datën raportuese ka transferuar gjithsej shumën prej EUR 44,741,706 në llogarinë bankare të Thesarit të Ministrisë së Financave për financimin e aktiviteteve administrative dhe operative të AKP-së:

PËRSHKRIMI	PËR BUXHETIN E VITIT	SHUMA
Transfer gjatë vitit 2011	2011	1,800,000
Transfer me 28 Maj 2012	2012	8,200,000
Transfer me 28 Dhjetor 2012	2013	8,048,000
Transfer shtesë me 18 Nëntor 2014	2014	2,300,000
Transfer shtesë me 15 Janar 2015	2015	5,500,000
Transfer shtesë me 15 Janar 2016	2016	6,300,000
Transfer shtesë me 20 Janar 2017	2017	6,100,000
Transfer shtesë për buxhetin e vitit 2018	2018	6,493,706
GJITHSEJ PAGESAT		44,741,706

Për financimin e Buxhetit të AKP-së për vitin 2018 janë realizuar dy transaksione: më datën 18 janar 2018 janë transferuar EUR 5.5 milion si dhe më datën 6 shtator 2018 janë transferuar EUR 993,706. Detajet janë në pasqyrat financiare të AKP-së

SQARIM LIDHUR ME TARIFËN ADMINISTRATIVE TË AKP-së

1. Tabela e sipër shënuar, nuk paraqet bilancin e të hyrave të dedikuara të realizuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, por paraqet shumat e transferuara nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së prej EUR **42,941,706** si dhe fondit rezervë prej EUR 1,800,000. Këto mjete janë transferuar për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative të AKP-së për vitet fiskale. Këtë llogari e menaxhon dhe administron Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave.
2. Në përputhje me nenin 15 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080:

Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuar si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të të ardhurave të Agjencisë.

14.1 TË HYRAT E REALIZUARA PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Nga viti 2003 deri në datën raportuese për të gjitha shitjet dhe të hyrat e tjera (konfiskime të BID depozitave dhe tarifa për pjesëmarrje të tenderëve) gjithsej të hyrat e realizuara janë **EUR 44,713,969**.

Ndërsa të hyrat e realizuara **vetëm për periudhën raportuese** janë **EUR 1,077,504** dhe atë:

TABELA A14.1 - RAPORT I TË HYRAVE TË DEDIKUARA PËR VITIN 2018

PËRSHKRIMI I LLOJEVE TË TRANSAKSIONEVE	Renditja	SHUMA
Gjendja e mjeteve të inkasuara të tarifës administrative me 31 dhjetor 2017	1	43,636,465
Konfiskimet e BID depozitave gjatë vitit 2018	2	27,000
Kthimi i mjeteve (anulim i shitjes) të BID depozitit të konfiskuar	3	(40,000)
Alokimi i mjeteve nga llogaria e tarifës për pjesëmarrje në tender	4	105,000
5% e vlerë të shitjeve të aseteve përmes likuidimit (kontrata të nënshkruara)	5	988,004
Kthimi i mjeteve (tepricave) të 5% nga shitjet përmes privatizimit	6	(2,500)
Bilanci i pranimeve dhe pagesave në llogari të tarifës	7=Σ(2:6)	1,077,504
GJITHSEJ BILANCI I TË HYRAVE ME 31 DHJETOR 2018	8=1+7	44,713,969

Ndërsa gjendja bankare e llogarisë të tarifës administrative më 31 dhjetor 2018 është **EUR 142,447**.

Buxheti i aprovuar i AKP-së për vitin 2019 është gjithsej EUR 8,276,049. AKP sipas Ligjit aktual në tarifën e të Hyrave të Dedikuara (THD), nuk ka mjete të mjaftueshme në dispozicion për të mbuluar të gjitha aktivitetet administrative dhe operative për vitin 2019. Prandaj, buxheti i AKP-së për vitin 2019 nga të Hyrat e dedikuara do të financohet vetëm në vlerën prej EUR 2,000,000, ndërsa pjesa tjetër e buxhetit në vlerë prej EUR 6,276,049 do të financohet nga Granti Qeveritar.

15. SHPENZIMET TJERA

Këto shpenzime përfshijnë avanset për udhëtime zyrtare të Zyrtarëve Ligjor dhe Zyrtarëve të Rastit për NSh-të në likuidim (përfaqësime gjyqësore jashtë territorit të Kosovës) dhe pagesat e tarifave për transaksionet dalëse nga llogarit bankare të fonde në mirëbesim që i aplikon BQK.

Bilanci i pagesave për periudhën raportuese prej EUR 37,650 është paraqitur si më poshtë:

PËRSHKRIMI	SHUMA
Pagesat e realizuara ndaj palëve të jashtme	37,762
Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative	(112)
GJITHSEJ	37,650

KOMPENZIMI NGA NSh NË LLOGARINË E TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shuma prej EUR 112 paraqitet si zbritje (minus) në kategorinë e shpenzimeve tjera ndërsa në anën tjetër është paraqitur si shpenzim (plus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Është fjala për korrigjimin e një transaksioni bankar që më pastaj llogaria bankare e NSh është kompensuar.

Ndërsa sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim ndaj **palëve të jashtme**, ato kryesisht janë për parane e imët/avanseve për udhëtime zyrtare jashtë vendit dhe shpenzimet e tarifave bankare. Shih tabelën e mëposhtme:

LLOJET E PAGESAVE

Shpenzimet nga paraja e imët në avans për shpenzime të vogla
Shpenzimet nga avanset për udhëtime zyrtare jashtë vendit
Shpenzime bankare/tarifa për transaksion

GJITHSEJ PAGESAT

SHUMA
25,079
6,697
5,986
37,762

Paraja e imët e dhënë në avanset për udhëtime zyrtare kanë të bëjnë me shpenzimet jashtë vendit. Këto shpenzime janë për përfaqësime në Gjykata për mbrojtjen e aseteve që gjenden jashtë vendit. Të gjitha procedurat dhe zbatueshmëria e rregullave mbështetet sipas rregullave të Ministrisë së Financave për udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Gjithashtu, avanse për udhëtime zyrtare jashtë vendit janë paraqitur në kategorinë mallra dhe shërbime tek **shënimi shpjegues nr. 10**.

16. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSh-ve NË LIKUIDIM

Bilanci i pagesave për periudhën raportuese është EUR 2,476,127 për 36 Ndërmarrjeve Shoqërore. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur pagesat gjatë vitit 2018 për vendimet e viteve 2016 - 2018:

LLOJET E KREDITORËVE	PËR VENDIMET E 2016	PËR VENDIMET E 2017	PËR VENDIMET E 2018	GJITHSEJ
Për paga të punëtorëve	6,228	165,682	691,465	863,375
ATK-ja	-	968	897,457	898,425
Trusti	-	6,407	189,513	195,920
Tatimi në pronë	-	2,202	42,519	44,721
Shërbimet publike	-	19,291	273,927	293,218
Kreditor të tjerë	480	-	179,988	180,468
GJITHSEJ	6,708	194,550	2,274,869	2,476,127

Ndërsa sa i përket tërë procesit nga viti 2011 deri më 31 dhjetor 2018, shumat e aprovuara dhe paguara janë sipas tabelës të mëposhtme:

LLOJET E KREDITORËVE	SHUMAT E APROVUARA			PAGESAT 2011 - 2018	PAPAGUAR
	DERI MË 31 DHJETOR 2017	JANAR – DHJETOR 2018	GJITHSEJ		
Për paga të punëtorëve	10,774,217	718,585	11,492,800	11,394,271	98,529
ATK-ja	4,842,031	897,457	5,739,488	5,739,374	114
Trustet pensionale	2,292,645	189,513	2,482,159	2,477,719	4,440
Tatimi në pronë	1,288,141	42,519	1,330,660	1,330,068	592
Shërbimet publike	907,977	273,934	1,181,911	1,174,241	7,670
Kreditor të tjerë	4,176,112	217,518	4,393,630	4,338,338	55,292
GJITHSEJ	24,281,125	2,339,526	26,620,651	26,454,011	166,637

*Shuma e pashpërndarë është EUR 159,584.67, mirëpo në tabelën e paraqitur më lartë si bilance të papaguara janë minsuar shumat e aprovuara kundrejt pagesave, meqenëse gjatë realizimit të pagesave nga shumat e aprovuar, për secilin transaksion zbritet tarifa bankare. Janë EUR 3,741 shpenzimet e tarifës bankare si dhe raste të tjera prej EUR 3,311 që kërkojnë korrëgjim (një pagesë e dyfishtë prej EUR -976.50 dhe EUR 4,287.78 që duhet korrëgjuar nga raporti i shpërndarjes)

Shumat e papaguar janë si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta dhe llogarive jo aktive bankare për të cilët ka pasur vështirësi në gjetjen e kontakteve të kreditorëve në fjalë. Në vlerat e përgjithshme të pashpërndarë prej EUR 159,584.67 përfshihet dhe shumat prej EUR 5,285.88 për NSh Letnica.

INFORMATË

- Në vitin 2015, ATK-ja me kërkesën e saj ka rezervuar mjetet prej EUR 192,357 për NSh në likuidim "Jugoterm". Mjetet e rezervuar në BQK janë si rezultat i vendosjes së barrës tatimore mbi asetet e kësaj NSh-je. AKP ka nënshkruar një "Marrëveshje të Mirëkuptimit" me ATK për trajtimin e barrës tatimore, por për rastin në fjalë është vendosur që të trajtohet deri në vendimin e Dhomës të Gjykatës Supreme të Kosovës;

2. Në vitin 2016, shuma prej EUR 6,893 të dedikuara për tatimin në pronë të kreditorit të Komunës të Skenderaj janë tërhequr nga ATK-ja si rezultat i vendosjes të “Barrës tatimore”. Tërheqja është bërë nga sistemi i Thesarit të Ministrisë së Financave. Kemi kërkuar që këto mjete të kthehen në llogari të AKP-së. Në fund të vitit 2018, më në fund kemi marrë premtimin se këto mjete do të kthehen.
3. Për arsye të emrit dhe mbiemrit të njëjtë të dy kreditorëve, gjatë realizimit të pagesës në vlerë prej EUR 976.20, një kreditor ka përfituar më shumë për NSh “Trasing”. Kreditori është njoftuar që t’i kthej mjetet dhe njëkohësisht janë marrë masat ligjore për rastin në fjalë.
4. Në Mars të vitit 2015, BQK-ja ka ekzekutuar urdhrin e përmbaruesit privat në shumën 3,194 për NSh në likuidim “Malishgani Klinë”. AKP-ja ka marrë të gjitha hapat ligjor dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve. Të gjitha institucionet relevante janë njoftuar për rastin në fjalë. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2018, përmbaruesi privat ka ekzekutuar mjetet prej EUR 628,496 nga llogari e NSh në likuidim “Pallati”.
5. Në fund të dhjetorit 2017, të hyrat prej EUR 2,460 për NSh Grand për shfrytëzimin e sallës nga AKP-ja, gjatë ekzekutimit të pagesës janë konfiskuar nga ATK-ja. Kjo si rezultat i marrëveshjes në mes të ATK-së dhe Thesarit, nëpërmjet të cilës, përmes sistemit automatikisht ekzekutohen pagesat në të mirë të ATK-së;
6. Gjithashtu, në vitin 2017 jemi njoftuar se, ATK-ja ka konfiskuar mjetet prej EUR 24,309 që është dashur të paguaj institucioni i Kosovës për shfrytëzimin me qira të asetit të NSh Mekanizimi. Mjetet janë konfiskuar në vitin 2016. Mënyra e konfiskimit të mjeteve është ngjajshëm si në rastin e sipër shënuar në pikën 5.

17. FONDET E TRANSFERUAR BUXHETIT TË KOSOVËS

Fondet e transferuara në buxhetin e Kosovës janë:

1. Fondet Tepricë sipas nenit 19.3.3 të Ligjit bazik nr. 04/L-034;
2. Fondet e mbetura sipas nenit 4, paragrafi 3.2.6 të Ligjit nr. 06/L-023 për plotësim dhe ndryshim; dhe
3. Fondet e përkohshme sipas nenit 4, paragrafi 3.2.7 të Ligjit nr. 06/L-023 për plotësim dhe ndryshim

Ligji nr. 06/L-023 për plotësim dhe ndryshim të Ligjit 04/L-034 ka hyrë në fuqi në muajin maj 2018.

Nëpërmjet tabelës të mëposhtme, pasqyrohen llojet e fondeve të transferuara Buxhetit të Kosovës nga viti 2012 deri më 31 dhjetor 2018.

Vitet e shpërndarjes	Fondet Tepricë	Fondet e mbetura	Fondet e përkohshme	GJITHSEJ
2012	28,934,282	-	-	28,934,282
2013	-	-	-	-
2014	-	-	-	-
2015	61,310,629	-	-	61,310,629
2016	-	-	-	-
2017	-	325,664	-	325,664
2018	-	42,226,452	43,920,006	86,146,458
GJITHSEJ	90,244,911	42,552,116	43,920,006	176,717,033

SHPJEGIM LIDHUR ME FONDET E TRANSFERUAR BUXHETIT TË KOSOVËS

1. Sipas Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080:
 - **Nenin 4, paragrafin 3.2.6 – Fondet e Mbetura janë:** Pas përmbushjes së vlefshme të kërkesave të kreditorëve në proces të likuidimit sipas Shtojcës së ligjit bazik, fondet e mbetura, nëse ka të tilla, barten nga Agjencia në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në një llogari të veçantë në Thesarin e Kosovës, dhe përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Në rast se Fondi në Mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, pas bartjes së fondeve të mbetura në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme pas procesit të ankesave në Dhomën e Posaçme, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë. Qeveria brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, ia kthen Agjencisë shumë nga nevojshme nga fondet e mbetura, të cilat Agjencia i përdorë për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse;
 - **Nenin 4, paragrafin 3.2.7 – Fondet e Përkohshme janë:** Pas llogaritjes së shumës së nevojshme për përmbushjen e vendimeve të vlefshme të kërkesave kreditore në proces të likuidimit, sipas Shtojcës së ligjit bazik dhe pas llogaritjes së fondeve të nevojshme për aktivitetet dhe proceset ligjore tjera të Agjencisë, Fondet e Përkohshme, nëse ka të tilla, barten nga Agjencia në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në një llogari të veçantë në

Thesarin e Kosovës, të cilat fonde të përkohshme përdoren për investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin afatgjatë ekonomik të vendit. Në rast se fondi në mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, pas transferimit të fondeve të përkohshme në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme pas procesit të ankesave në Dhomën e Posaçme apo për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë sipas ligjit bazik, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë. Qeveria brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, ia kthen Agjencisë shumën e nevojshme nga fondet e përkohshme, të cilat Agjencia i përdorë për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit dhe mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë, që ndërlidhen me Ndërmarrjen Shoqërore përkatëse;

2. Sipas paragrafit 3.3 të nenit 19 të ligjit bazik nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit, **Fondet Tepricë janë:** Agjencia përcakton dhe deklaron si “Fonde Tepricë” deri ne shtatëdhjetë e pesë përqind (75%) të çdo të ardhure që e tejkalon maksimumin e vlerës së përlogaritur të grumbulluar të pretendimeve përkatëse të kreditorit dhe interesave të pohuara të pronësisë, dhe menjëherë i transferon ato Fonde Tepricë “para publike” dhe trajtohen në pajtim me LMFP të cilat do të shfrytëzohen për zhvillimin ekonomik të vendit, me aprovim të Kuvendit të Kosovës.

LLOGARITË E ARKËTUESHME

Llogaritë e arkëtueshme janë obligimet e papaguara nga palët e treta ndaj Agjencisë, të cilat paraqiten vetëm si shpalosje. Llojet e të hyrave për Agjencinë janë si më poshtë:

- pjesët e papaguara nga valët e privatizimit/likuidimit dhe shitjeve përmes negocimit direkt;
- ndëshkimet financiare për valët e “spin off-ve special”; dhe
- qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSh-ve.

Të gjitha këto të dhëna janë të paraqitura nga Njësia për Kontroll dhe Mbikëqyrje, Zyrat Regjionale përmes Departamentit të Koordinimit të Rajonal dhe Departamenti i Shitjes.

Ashtu siç është paraqitur edhe më lartë, sa i përket llogarive të arkëtueshme janë paraqitur vetëm si shpalosje në këto pasqyra, pasi që pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme.

Gjendja e llogarive të arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

LLOJET E LLOGARIVE TË ARKËTUESHME	PERIUDHA		31 dhjetor 2018
	Deri me 31 dhjetor 2017	Janar – dhjetor 2018	
Ndëshkimet me Spin-Off Speciale	29,893,285	1,140,500	31,033,785
Nga shitja e aseteve	18,095,297	(2,712,898)	15,382,399
Nga shpronësimi i aseteve të NSh-ve	-	4,837,468	4,837,468
Të hyra nga qiraja	13,802,490	162,581	13,965,071
GJITHSEJ	61,791,072	3,427,651	65,218,723

Sa i përket llogarive të arkëtueshme nga **shpronësimi i aseteve të NSh-ve**, është një rast për të cilën në bazë të marrëveshjes, Komuna e Prishtinës është zotuar që të bëjë **pagesën** për shpronësimin e asetit të NSh IMN Kosova. Në bazë të kësaj marrëveshje, është pajtuar që shuma prej **EUR 4,837,467.82** të paguhet gjatë vitit 2018 dhe vitit 2019 me këtë plan dinamik:

1. Këstin e parë prej **EUR 2,515,845** do të duhej që pagesa të realizohet deri më 31 Dhjetor 2018 për proceset e mëposhtme:
 - EUR 2,321,621.18 për 20%-in e punëtorëve;
 - EUR 192,223.82 për kërkesat kreditore të aprovuara nga Autoriteti i Likuidimit (neni 6A, paragrafi 3 i ligjit të AKP-së);
 - EUR 2,000 për shpenzimet administrative deri në përmbylljen e likuidimit.
2. Këstin e dytë prej **EUR 1,160,811.82** për 20%-in të punëtorëve në muajin Shtator të vitit 2019; dhe
3. Këstin e tretë prej **EUR 1,160,811.00** për 20%-in të punëtorëve në muajin Dhjetor të vitit 2019;

18. NDËSHKIMET NDAJ NSh-ve ME SPIN-OFF SPECIAL

Janë ndëshkimet në vlerë monetare ndaj blerësve për zotimet e dhëna për disa Ndërmarrje të Reja, që përveç çmimit të ofertës, ofertuesit kanë dorëzuar dhe ofertat lidhur me investimet për këto Ndërmarrje.

Shitjet janë realizuar edhe me kushte të tilla si: vazhdimi i operimit të aktivitetit të NSh-ve, me investimet e zotuar dhe numrin e punëtorëve. Këto raste kanë qenë **“Shitjet me Kushte të Veçanta”** dhe shitjet me **“Spin Off Special”**. Deri më tani, ndëshkimet financiare e aplikuar për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet për NSh-të e mëposhtme janë:

TABELA A18 - NDËSHKIMET FINANCIARE ME SPIN-OFF SPECIAL

PËRSHKRIMI	Renditja	SHUMA
Gjendja e ndëshkimeve financiare deri me 31 dhjetor 2017	1	29,893,285
Pagesa e ndëshkimeve nga IDGJ Tobacco – <i>shih shënimin shpjegues nr.6</i>	2	(29,500)
Ndëshkimet financiare ndaj Famipa Prizren në vitin 2018	3	1,170,000
Gjendja e ndryshimeve të ndëshkimeve financiare gjatë vitit 2018	4=Σ(2:3)	1,140,500
GJITHSEJ NDËSHKIMET FINANCIARE DERI ME 31 DHJETOR 2018	5=1+4	31,033,785

Lista detaje e ndëshkimeve financiare për ndërmarrjet e privatizuara me “Spin Off Special” është si më poshtë:

NDËRMARRJEVE	31 Dhjetor 2017	1 janar 31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2018	Komente
Grand Hotel	8,822,315	0.00	8,822,315	Nuk ka ndryshime nga viti 2014
IDGJ Tobacco	29,500	(29,500)	0.00	Pagesa është realizuar në vitin 2018 prej EUR 29,500. Në vitin 2017, me vendim të Bordit të drejtorëve janë shlyer ndëshkimet financiare në shumën prej EUR 4,573,649 dhe ishin aplikuar ndëshkime te reja prej EUR 29,500
Xim Strezovc	7,298,171	0.00	7,298,171	Nuk ka ndryshime nga viti 2014
MIM Golesh	8,447,812	0.00	8,447,812	Nuk ka ndryshime nga viti 2014
Agrokosova Holding	3,579,998	0.00	3,579,998	Nuk ka ndryshime nga viti 2014
Llamkos	1,715,489	0.00	1,715,489	Në vitin 2015 janë aplikuar ndëshkime shtesë prej EUR 29,029
Famipa Prizren	0.00	1,170,000	1,170,000	Ndeshkime financiare 2018
GJITHSEJ	29,893,285	1,140,500	31,033,785	

Për ndërmarrjet Shoqërore “Agro-Kosova Holding” dhe “Llamkos Galvasteel”, Bordi i Drejtorëve ka vendosur që të priten vendimet gjyqësore dhe pastaj të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm. Sa i përket ndërmarrjeve që u janë marrë aksionet “Grand Hotel” Prishtinë; “Mim” Golesh dhe “Xim” Strezoc, Bordi i Drejtorëve i AKP-së, në mbledhjen e mbajtur me 23 nëntor 2018 me vendimin numër BD-110/14 ka marrë vendim që të tentohet inkasimi i tyre përmes hapave ligjor.

Ndërsa, gjatë vitit 2018 janë aplikuar ndëshkimet financiare për Ndërmarrjen e Re “Famipa” Prizren në vlerë prej 1,170,000.00 Euro për shkak të mos përmbushjes së kushteve të kontratës. Blerësi ka bërë ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për aplikimin e këtij ndëshkimi.

19. SHITJA E ASETVE

Gjendja e llogarive të arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2018 është **EUR 15,382,399**. Nga viti paraprak 2017, llogaritë e arkëtueshme janë zvogëluar si rezultat i pranimit të pagesave gjatë vitit 2018 për shitjet e aseteve që janë tenderuar në vitet e kaluara dhe për të cilat janë nënshkruar kontratat.

Më poshtë paraqesim ngjarjet gjatë periudhës raportuese të llogarive të arkëtueshme:

TABELA A19 - LLOGARITË E ARKËTUESHME PËR SHITJEN E ASETVE

PËRSHKRIMI	RENDITJA	SHUMA
Gjendja e llogarive të arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2017	1	18,095,297
Pagesat e realizuara të llogarive të arkëtueshme të viteve paraprake	2	(13,277,524)
Anulim i shitjeve të tenderuara nga llogaritë e arkëtueshme 2017	3	(1,739,081)
Llogari të arkëtueshme gjatë vitit 2018	4	12,303,707
Gjendja e ndryshimeve të llogarive të arkëtueshme gjatë vitit 2018	5=Σ(2:4)	(2,712,898)
LLOGARITË E ARKËTUESHME MË 31 DHJETOR 2018	6=1+5	15,382,399

Llogaritë e arkëtueshme të vitit 2018 janë EUR 12,303,707 si dhe ato të bartura nga viti 2017 prej EUR 3,078,692. **Në total prej EUR 15,382,399**

19.1. Llogaritë e arkëtueshme të vitit 2018

Llogaritë e arkëtueshme që kanë ndodhur gjatë vitit 2018 kanë të bëjnë me procesin e tenderimit të shitjeve të aseteve të likuidimit të valëve 40-43, shitjeve të aseteve përmes negociimit direkt si dhe shuma shtesë që duhet paguar blerësi si **“çmim i shitjes”** për NSh Sharrcem. *Për me tepër shih të dhënat financiare në tabelën e mëposhtme:*

Përshkrimi	Janar – dhjetor 2018
*Shitjet e aseteve përmes valëve të privatizimit	2,806,513
*Shitjet e aseteve nga negociimi direkt	55,425
**Shuma shtesë si çmim i shitjes për Nder. e Re Sharrcem	9,441,769
GJITHSEJ	12,303,707

*Llogaritë e arkëtueshme përmes valëve të privatizimit dhe shitjes përmes negociimit direkt janë llogari që potencialisht mund të inkasohen, meqenëse për këto raste nuk është përfunduar procesi i nënshkrimit të kontratave. Ashtu siç është thënë edhe më lartë, llogaritë e arkëtueshme në këtë rast paraqitet vetëm si shpalosje e informacioneve pas pasqyrat financiare.

**Për Ndërmarrjen e Re “Sharrcem” Hani i Elezit, Bordi i Drejtoreve i AKP-se në mbledhjen e mbajtur me 23 nëntor 2018 me vendimin numër BD- 110/14 ka vendosur që vlera e mos përmbushjes së zotimeve për investime kapitale prej 9,441,768.83, bazuar në raportin e auditorit të pavarur të llogaritet si çmim i blerjes se

aksioneve e cila është e parapare me kontratën e shitjes. Nga këto mjete që pranohen paguhen 20% i punëtoërve, 5% i tarifës administrative të AKP'së dhe kosto e likuidimit.

19.2. Llogaritë e arkëtueshme të vitit 2017 të bartura në vitin 2018

Ndërsa, gjendja e llogarive të arkëtueshme të vitit 2017 dhe bartura në vitin 2018 janë EUR **3,078,692** dhe kanë të bëjnë me masat e përkohshme për shitjen e tyre nga Gjykata dhe ato janë:

Lista detaje e llogarive të arkëtueshme të vitit 2017 të bartura në vitin 2018

Llogaritë e arkëtueshme që janë bartur nga viti 2016 prej EUR **617,134** kanë të bëjnë vendosjen e masës të përkohshme nga DHPGJSK

- Privatizim Vala 37 për Agrokosova Offices shuma prej EUR 321,111;
- Privatizim Vala 43 për Punëtorja Iliria në shumën prej EUR 223,223; dhe
- Likuidim 20 për asetit e NSh Lavërtari Blegtori në shumën prej EUR 72,800.

Gjatë **vitet 2017** janë vendosur masa të përkohshme edhe për shitjet e mëposhtme të cilat janë pjesë e llogarive të arkëtueshme. Shuma totale këtyre rasteve është EUR **2,461,558** dhe atë:

- Likuidimi 29 për NSh Rekreators, njësia 34 në shumën prej EUR 70,777;
- Likuidimi 35 për NSh Gërmia, njësia 43 në shumën prej EUR 1,800,000;
- Likuidimi 35 për NSh Zetatrans, njësia 47 në shumën prej EUR 112,456; dhe
- Likuidimi 35 për NSh Lavertari Blegtori, njësia 55 në shumën prej EUR 478,325.

20. QIRAJA DHE TË HYRAT TË TJERA

RAPORTI I LLOGARIVE TË ARKËTUESHME TË QIRAVE SIPAS ZYREVE REGJIONALE

	A	B	C=A+B	1	2	3=1/C	4=2/C
REGJIONET	31 dhjetor 2017	Ndryshimet gjatë vitit 2018	31 dhjetor 2018	Qiraja e rregulltë	PADI GJYQËSORE	%	%
*ZR Prishtina	11,310,170	119,067	11,429,237	1,600,170	9,829,067	14.00%	86.00%
ZR Pejë	67,053	46,899	113,952	12,110	101,842	10.63%	89.37%
ZR Mitrovicë	1,003,181	(56,137)	947,044	58,030	889,014	6.13%	93.87%
ZR Gjilan	1,356,548	53,864	1,410,412	11,402	1,399,010	0.81%	99.19%
ZR Prizren	65,538	(1,112)	64,426	5,542	58,884	8.60%	91.40%
GJITHSEJ	13,802,490	162,581	13,965,071	1,687,254	12,277,817	12.08%	87.92%

*Vlera prej EUR 11,310,170 e prezantuar në vitin 2017 ka përfshirë edhe llogaritë e arkëtueshme NSh Pallati. Me 31 dhjetor 2018, llogaritë e arkëtueshme të NSh Pallati nuk përfshihen, meqenëse nga data 11 shtator 2018 këto llogari janë transferuar në Komunën e Prishtinës, nën statusin e Ndërmarrjes Publike. Vlera e prezantuar në pasqyrat financiare 2017 për NSh Pallati janë EUR **399,595** dhe këto llogari së bashku me llogaritë e arkëtueshme të vitit 2018 janë transferuar nën kompetencën e komunës të Prishtinës. Sipas marrëveshjes, të datës 11 shtator 2018, gjendja e llogarive të arkëtueshme të transferuar nën kompetencën e Komunës janë EUR 791,085. Gjithashtu duhet theksuar, se nga data 11 shtator 2018, janë inkasuar mjetet nga qiraja prej EUR 86,077.59 në llogarinë bankare të NSh'së në likuidim të cilën më përpara e ka administruar AKP'ja, mirëpo të gjitha këto janë konfiskuar nga përmbartuesi privat. AKP'së nuk i është lejuar që të bëjë mbylljen e kësaj llogarie për shkak se është nën-administrimin e përmbartuesve dhe se pothuajse gjatë gjithë vitit ekzekutimi i pagesave për pagat, shërbimet publike dhe tjera janë ekzekutuar me leje të përmbartuesve privat.

Po që se largojmë NSh Pallati nga shënime të vitit 2017, atëherë shuma prej EUR 162,581 (rritje në total, shih **kolonën B më lartë**) do të rritet prej EUR **562,176** (399,595+162,581). Rritjet e llogarive të arkëtueshme në krakasim me vitin 2017, kryesisht i paraqesim si më më poshtë:

- NSh Ina Trgovina, rritje prej EUR 306,498 nga shuma e prezantuar në vitin 2017. Ende nuk është arritur një marrëveshje për kushtet e kontratës;
- NSh Tregu, rritje prej EUR 43,999 nga shuma e prezantuar në vitin 2017;
- NSh Banka e Bashkuar, rritje prej EUR 49,443 nga shuma e prezantuar në vitin 2017. Kjo rritje është se qiramarrësit kanë hezitur që me kohë t'i bëjnë pagesat e tyre pasi që disa nga ta kanë pasur edhe borxhe të riprogramuara, dhe për këtë arsye të gjithë ata që kanë qenë me borxhe i kemi dërguar tek Përmbartuesi dhe për disa kemi bërë Padi Gjyqësore dhe tani presim që përmes Përmbartuesit dhe gjykatës të bëjmë inkasimin e borxheve të mbetura.

Sa i përket kolonës 1 dhe 2 në tabelën e mësipërme, nga shuma prej EUR 13,965,071, në proces gjyqësor i kemi dërguar shumën prej EUR 12,277,817 apo 87.92% të rasteve, ndërsa rastet që konsiderohen si qiradhënie e rregulltë apo që nuk janë në procedurë gjyqësore prej EUR 1,687,254. Nëpërmjet tabelës të mëposhtme po i paraqesim disa shënime për rastet që janë në proces gjyqësor dhe rastet që konsiderohen si qiradhënie e rregulltë dhe/apo komente të shkurtra lidhur me rritjen e llogarive të arkëtueshme.

PËRMBLEDHJE E SHPJEGIMEVE TË LLOGARIVE TË ARKËTUESHME NË VLERËN PREJ EUR 13,965,071

Regjioni	Ndërmarrja Shoqërore	LL/A deri më 31 dhjetor 2018		KOMENTE
		Qira e rregulltë	Padi	
ZR PRISHTINA	NSh Tregu	447,665	50,517	Obligime kryesisht të trashëguara
	NSh Jugopetrol dhe Nsh Ina Trgovina	0.00	8,708,329	Faturimi ndaj Kosova Petrol për shfrytëzimin e asetëve të NSh-ve "INA TRGOVINA" dhe "JUGOPETROL" për periudhën nga Shkurti i vitit 2000 deri më 30 Prill 2016. Obligimi është EUR 8,708,329. Fatura e parë për obligimet është lëshuar gjatë vitit 2014. Për shfrytëzimin e këtyre asetëve për periudhën e sipër shënuar është ngritur padi ndaj Kosova Petrol në organet përkatëse.
	NSh Ina Trgovina	712,069	702,861	NSh Ina Trgovina në total në shumën prej EUR 1,450,162 (vetëm ndaj "AI Petrol" në shumën prej EUR 702,861 dhe "Industria e Naftes INA D.D. Zagreb" në shumën prej EUR 712,069). Ndaj "AL – Petrol" çështja është në procedurë gjyqësore, në shkallën e parë ka fituar AKP'ja
	Grand Hotel	55,160	13,339	Në total prej EUR 68,499
	Auto Prishtina	65,745	19,378	Në total prej EUR 85,123
	Rilindja Grafike	46,034	124,047	Në total prej EUR 170,081
	Germia	5,258	59,827	Në total prej EUR 65,085
	Jugopetrol	45,377	74,976	Në total prej EUR 120,353
	Mekanizimi	57,108	4,795	Në total prej EUR 62,083
ZR GJILAN	17 Nentori	0.00	123,927	Për të gjitha rastet e NSh 17 Nëntori Ferizaj janë iniciuar procedurat gjyqësore
	Nsh Sharr	0.00	81,254	Për të gjitha rastet e NSh Sharr anë iniciuar procedurat gjyqësore
	Sharr Hani i Elezit	0.00	669,029	Për të gjitha rastet e NSh Sharr Hani i Elezit anë iniciuar procedurat gjyqësore
	Morava e Binçes	0.00	100,522	Për të gjitha rastet e NSh Morava e Binçes janë iniciuar procedurat gjyqësore
ZR PEJA	Rritja e llogarive të arkëtueshme ka ardhur si rezultat i rasteve të dërguara tek përmbaruesi që kanë të bëjnë me aktgjykimet e plotfuqishme në favor të NSH-ve si dhe qiratë joaktive të dërguara tek përmbaruesit të cilat ende nuk janë inkasuar.			
ZR GJILAN	Shumat e rritura në krahasim me vitin 2017 janë si rezultat i të rasteve të reja të iniciuara në procedurat gjyqësore gjatë vitit 2018.			

LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

Obligimet e papaguara janë të paraqitura në tri shtylla:

1. Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit);
2. Mallrat dhe Shërbimet; dhe
3. Obligimet ndaj Kërkesave të Kreditorëve;

Obligimet e papaguara deri më 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

1Σ(1:4)

Departamentet/ Njësitë dhe Regjionet	Deri më 31 Dhjetor 2017	Ndryshimet Gjatë Vitit 2018	Gjithsej
Departamenti i Likuidimit	306,087	(42,363)	263,724
ZQ – MIM Golesh	328	(328)	0.00
ZR Prishtinë	43,150	(1,698)	41,452
ZR Mitrovicë	1,807	16,526	18,333
ZR Pejë	193	(193)	0.00
ZR Gjiilan	21,259	(21,259)	0.00
ZR Prizren	4,169	(4,169)	0.00
GJITHSEJ	376,993	(53,484)	323,509

LLOJET E LLOGARIVE TË PAGUESHME		
2	3	4
Ofruesi i Shërbimeve Profesional e	Mallra dhe Shërbime	Kreditorët e NSh-ve
0.00	104,139	159,585
0.00	0.00	0.00
0.00	41,452	0.00
0.00	18,333	0.00
0.00	0.00	0.00
0.00	0.00	0.00
0.00	0.00	0.00
0.00	163,924	159,585

Nga llogaritë e pagueshme të vitit 2017, janë dy raste të cilat janë bartur në detyrimet kontingjente:

- Shpalle në gazeta prej EUR 323. Këto obligime më përpara janë raportuar si obligime për shkak se kanë tejkaluar vlerën e kontraktuar. Të gjitha rastet e tilla janë procesuar për pagesë, mirëpo vetëm për një gazetë vendore nuk janë procesuar, për shkak se blerësi i ri i kësaj gazete nuk ka shprehur interes që të pranojë këto pagesa. Këto raste në vitin 2017 kanë qenë të raportuara në kuadër të Departamentit të Likuidimit, kategoria “Mallra dhe “Shërbime”;
- Faturat e shërbimeve të sigurimit fizik prej EUR 17,160 për të cilën nga Kompania nuk është iniciuar kërkesë për pagesën e tyre dhe në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet detyimore këto pretendime parashkruhen.

SQARIM LIDHUR ME OBLIGIMET E PAPAGUARA

Sa i përket obligimeve, ato njihen nga data e pranimit të faturë. Ndërsa për Ofruesit e Shërbimeve me përfundimin e shërbimeve.

Shuma prej EUR 159,585 e papaguar e paraqitur për kreditorët mund të ketë ndryshime, për shkak të kthimit të mjeteve (mos ekzekutimit) nga bankat komerciale për mos ekzekutim të pagesës. Pra mund të ketë ende raste që nuk janë ekzekutuar e që bankat na njoftojnë në janar 2019.

Shuma prej EUR 163,924 e paraqitur tek kolona Mallra dhe Shërbime kryesisht janë fatura që janë pranuar për pagesë në fund muajit dhjetor 2018 apo në muajin janar 2019 (kryesisht shërbimet komunale)

21. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Sa i përket obligimeve ndaj OShP-së, për periudhën e përfunduar më 31 Dhjetor 2018, nuk ka asnjë faturë pa paguar. Si pjesë e kontraktuar, bilanci i papaguar paraqet mjetet në dispozicion sipas vlerës të kontraktuar dhe është obligim për vitin 2018 vetëm për pjesën e aneks kontratës me kontraktorin

Për OShP-në, më gjerësisht është *shpalosur në shënimin shpjegues nr. 9*

22. MALLRA DHE SHËRBIME

Shuma prej **EUR 163,924** janë për ofruesit e shërbimeve të cilët angazhohen për NSh-të përkatëse, shërbimet për ruajtjen e aseteve, shpalljet në gazeta për shitjen e aseteve përmes likuidimit, shpalljet lidhur me njoftimet për kërkesat e kreditorëve, qiraja, shërbimet publike dhe të tjera.

Më poshtë janë paraqitur detajet. Shih në faqen tjetër.

PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE TË NDODHURA	VLERA
Shpallje në gazeta	285
Shpenzimet për ofruesit e Shërbimeve	953
Qiraja për muajin dhjetor 2017 nga NSh Tregu për pronësinë e përbashkët	3,000
Shërbimet profesionale/juridike	2,971
Shpenzimet e telekomunikimit	272
Shpenzimet për pastrimin e mbeturinave	7,008
Shpenzime për rrymë	14,586
Furnizim me material higjienik dhe artikuj ushqimor për ABC Genci	104
Shërbime postare	545
*Tatimi i mbajtur në burim për pagesat e OShP-së dhe pagat e punëtorëve të NSh-ve	6,691
*Tatimi i mbajtur në burim për qiranë e paguar nga AKP për NSh Grand Hotel	46
*Tatimi në fitim nga qiraja e inkasuar për NSh-të përkatëse	26,677
*Tatimi mbi vlerën e shtuar nga qiratë e inkasuara	68,404
*Kontributet pensionale e muajit dhjetor 2018 për OSh-te dhe punetoret e NSh-ve	19,824
Shpenzime për ngrohje qendrore për muajin dhjetor 2018 për NSh Grand	12,283
Pagesa ndaj distributorëve të filmave për ABC Genci	248
Shpenzime për furnizim me ujë	27
GJITHSEJ	163,924

Sa i përket obligimeve të tatimeve dhe kontributeve pensionale, këto janë pasqyruar si rezultat i kërkesave për pagesë të paraqitur në muajin janar 2019, por që kanë të bëjnë me periudhën 2018. Të gjitha këto raste janë procesuar për pagesë në vitin 2019 duke përfshirë edhe obligimet tjera të tilla si ujë, rrymë dhe tjerat që janë prezantuar më lartë.

23. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSh-ve

Ashtu siç është përmendur edhe në *shënimin shpjegues nr. 16*, obligimet e papagura janë pagesat e parealizuar ndaj kreditorëve të NSh-ve sipas vendimit për shpërndarje të Bordit të Drejtorëve.

Vlera e mbetur për tu paguar prej EUR 159,585 janë si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta të llogarive bankare. AKP-ja ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të vënë në kontakt kreditorët në fjalë (edhe përmes reklamave në TV). AKP-ja së fundi ka vënë në përdorim edhe aplikacionin në uebfaqen e saj zyrtare në menyrë që kreditorët të informohen me të dhënat e fundit rreth procesit të shpërndarjes. Këto veprime kanë pasur efekt në shpërndarjen e informacionit ndaj kreditorëve për të cilët janë aprovuar shumat për shpërndarje.

24. DETYRIMET KONTIGJENTE

Janë konteste gjyqësore të pazgjidhura për një numër të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Raporti përmbljedhës i detyrimeve kontingjente:

TABELA A24 - DETYRIMET KONTIGJENTE

PËRSHKRIMI	Renditja	SHUMA
Gjendja e detyrimeve kontingjente deri më 31 dhjetor 2017	1	5,432,014
Konteste të fituara nga palët e treta	2	(60,587)
Rastet e fituara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit	3	(4,945,129)
Raste të reja të paraqitura gjatë vitit 2018	4	7,267,629
Gjendja e ndryshimeve të llogarive të arkëtueshme gjatë vitit 2018	5=Σ(2:4)	2,261,913
GJENDJA E DETYRMEVE KONTIGJENTE MË 31 DHJETOR 2018	6=1+5	7,693,927

Kosto për AKP-në dhe të prezantuar gjatë vitit 2017 janë EUR 60,587 dhe e cila është paguar në vitin 2018, shih shënimin shpjegues nr. 13 dhe nr 7.

Ndërsa rastet e fituara nga AKP-ja janë në vlerën prej EUR 4,945,129. Në këtë vlerë trajtohet vetëm kryegjësja dhe nuk janë të përllogaritura kamata dhe ndëshkimet financiare. Sipas gjykimeve, raste të tilla në rast se AKP do të humbte, vlera do të ishte shumë më e lartë, marrë parasysh ndëshkimet dhe interesi.

Pjesa tjetër prej EUR 7,267,629 janë raste të reja gjatë vitit 2018 dhe sipas vlerësimeve të Departamentit Ligjor, mundësit që AKP-ja të humb nga këto raste janë kryesisht të shkallës të ulët. Detajet në lidhje me detyrimet kontingjente janë paraqitur në tabelën e më poshtme:

		GJITHSEJ	5,432,014	2,261,913	7,693,927
			1	2	3=1+2
NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	MUNDËSIA	VLERA POTENCIALE 2017	NDRYSHIMET GJATË VITIT 2018	VLERA MË 31 DHJETOR 2018
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbaues P. nr.397/2015, kompensim në shumë prej 2.640.00 Euro	e lartë	2,640	0.00	2,640
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-09-0135, shpenzime procedurale, në shumë prej 1,500 Euro	e lartë	1,500	0.00	1,500
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-08-0095 - Padia për humbjen e fitimit, kompensimit në shumën prej 14,478,50 si dhe avokatin në shumën prej 365,04 Euro.	e lartë	14,844	0.00	14,844
Kompensim	Sipas Aktgjykimit SCC-07-0059-Urdhërohet AKM-ja, t'ia bëjë pagesën prej 59,807,04, si dhe shpenzimet e gjykatës prej 780 eurove. NSh Famipa	E paguar	60,587	(60,587)	0.00
Kompensim	Aktgjykimi SCC-10-00214, AKP-ja detyrohet për pagesën e 35,400. NSh Magjistralia Peje	e lartë	35,400	0.00	35,400
Kompensim	Aktgjykimi SCC-06-0348, NSh Ratko Mitrovicë	e lartë	122,994	0.00	122,994
Kompensim	Aktgjykimi SCC-10-0091, AKP-ja detyrohet për pagesën e 113.794	e lartë	113,794	0.00	113,794
Kompensim	Aktgjykimi Cnr.190/2007 NSh Auto Prishtina	e lartë	35,725	0.00	35,725
Kompensim	Aktgjykimi Cnr.185/2009. për NSh Ujmiri në likuidim	e lartë	70,000	0.00	70,000
Kompensim	aktgjykim AC-II-12-0006 për NSh Agrokultura	e lartë	2,296	0.00	2,296
Kompensim	Sipas aktgjykimit AC-I-17-0257, agjencia është e obliguar t'i paguaj shpenzimet procedurale	e lartë	203	0.00	203.00
Kompensim	Sipas Aktgjykimit C-II-14-0118, kompensimi i të ardhurave personale	e lartë	26,247	0.00	26,247
Kompensim	Lënda nr. SCC-08-0199 Kërkesë për shërbime menaxheriale nga KEK-u.	E fituar nga AKP	4,945,129	(4,945,129)	0.00
Kompensim	Sipas aktgjykimit C-III-17-0076, AKP-ja është e obliguar t'i pagua paditesit kompensimin ne emer te kontrates se pa permbushur.	e lartë	0.00	8,300	8,300
Kompensim	Sipas aktgjykimit C-II-17-0069, AKP-ja është e obliguar t'i paguaj shpenzimet e përfaqësuesit të ankuarit.	e lartë	655	0.00	655
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-III-15-1026, pretendon që AKP-ja, ne emer te kompensimit per shfytëzimin e lokalit afarist.	E ultë	0.00	174,891	174,891
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-I-17-0033, pretendon që AKP-ja, ne emer te kompensimit për pronën.	E ultë	0.00	2,985,945	2,985,945
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-II-13-0325, pretendon që AKP-ja, ne emer te kompensimit për pronën.	E ultë	0.00	84,000	84,000
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-III-17-0211, pretendon që AKP-ja, ne emer te borgjit per mospagesen e sherbimeve.	E ultë	0.00	41,828	41,828
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-I-16-0005, pretendon që AKP-ja, ne emer dëmit material dhe jomateriale.	E ultë	0.00	280,000	280,000
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-I-16-0016, pretendon që AKP-ja, ne emer te kompensimit te pagave të papaguara.	E ultë	0.00	33,000	33,000
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-II-16-0662, pretendon që AKP-ja, ne emer te kompensimit te paguaj të pa paguara.	E ultë	0.00	2,100	2,100
Kompensim	Paditesi perms padis se tij SCC-11-0158, pretendon që AKP-ja, ne emer te kompensimit të pronës.	E ultë	0.00	975,526	975,526
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-III-16-0125, pretendon që AKP-ja, ne emer te kompensimit të dëmit material dhe jomaterial.	E ultë	0.00	150,000	150,000

		GJITHSEJ	5,432,014	2,261,913	7,693,927
			1	2	3=1+2
NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	MUNDËSIA	VLERA POTENCIALE 2017	NDRYSHIMET GJATË VITIT 2018	VLERA MË 31 DHJETOR 2018
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-IV-12-0020, pretendon që AKP-ja të bejë, kthimin e depozitës.	E ultë	0.00	7,100	7,100
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-I-12-0055, pretendon që AKP-ja, ne emer te mospermbushjes se kontrates.	E ultë	0.00	138,126	138,126
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-II-17-0623, pretendon që AKP-ja, ne emer te kompensimit te pagave te pa paguara.	E ultë	0.00	6,300	6,300
Kompensim	Aktgjykimi SCC-05-0010, AKP-ja detyrohet për pagesën e 1,200.00	E lartë	0.00	1,200	1,200
Kompensim	Aktgjykimi C-IV-14-3940, AKP-ja, detyrohet që paditësit t'ia kthej depozitën.	E lartë	0.00	2,000	2,000
Kompensim	Aktgjykimi C-II-14-0118, AKP-ja detyrohet per pagesë e pagave te pa paguara.	E ultë	0.00	26,247	26,247
Kompensim	Aktgjykimi C-IV-14-3627, AKP-ja detyrohet për t'i kthyer paditësit depozitën dhe shpenzimet e procedures.	E lartë	0.00	2,494	2,494
Kompensim	Paditesi perms padis se tij C-III-17-0013, pretendon që AKP-ja, ne emer te mospermbushjes se kontratës.	E ultë	0.00	2,331,089	2,331,089
Fatura	Fatura të gazetës të papaguara që më parë janë ndalur për shkak të tejkalimit të vlerës të kontratës, por që blerësi I ri I kompanisë nuk ka shprehur interesin që të pranojë këto pagesa. Këto obligime në pasqyrat financiare 2017 kanë qenë të prezentuara si obligime por që kalojnë në detyrime kontigjente.	E ultë	0.00	323	323
Fatura	Faturë e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 2011-2012. Këto obligime në pasqyrat financiare 2017 kanë qenë të prezentuara si obligime por që kalojnë në detyrime kontigjente.	E ultë	0.00	17,160	17,160

PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE

Sipas ventimit të Bordit të Drejtorëve të vitit 2012, në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit dhe NSh-ve tjera, atëherë pagesat realizohen përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim. Gjithashtu, pagesat nga llogaria e tarifës administrative dhe kompenzimi i kësaj llogarie nga NSh-të në likuidim është në pajtueshmëri dhe me nenin 20 të Ligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin nr. 05/L-080.

Gjatë periudhës raportuese, bilanci i hyrjeve/daljeve nga llogaria e tarifës administrative është si më poshtë:

Gjendja bankare e llogarisë së tarifës administrative më 31 Dhjetor 2017		SHUMA 6,086,620
Shuma e transferuar shtesë për buxhetin e vitit 2018 <i>[shënimin shpjegues nr. 14]</i>	-	(6,493,706)
Gjithsej mjetet e paguara për tarifën fikse sipas aneks kontratës <i>[shënimin shpjegues nr. 9]</i>	-	(581,000)
Shpenzime për dërgesa postare - <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(7,101)
Bilanci i pagesave për Ofruesit e Shërbimeve <i>[shënimin shpjegues nr. 10.1]</i>	-	(144,253)
Provizione për ruajtjen e artikujve në Bankën Qendrore të Kosovës <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(3,150)
Pagesa e urdherit permbarimor <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(116)
Pagesa NSh Grand Hotel për shfrytëzimin e sallës - valët e privatizimit <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(554)
Shpalle në gazeta vendore dhe ndërkombëtare <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(16,152)
Marketingut, mirëmbajte/uebfaqes, rryma, taksa gjyqë/ tjera <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(1,997)
Tatimet/Trustet Pensionale për OSh-të nga tarifa për NSh-të <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(21,491)
Shpenzime bankare <i>[shënimin shpjegues nr. 15]</i>	-	(746)
Shpenzimet nga paraja e imët nga Zyret Regjilonale <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(23,038)
Shpenzimet nga avansi për udhëtim zyrtar jashtë vendit <i>[shënimin shpjegues nr. 10]</i>	-	(11,820)
Rimbursimi i mjeteve nga llogaritë e NSh-ve që janë paguar nga tarifa administrative	+	111,067
Të hyrat për Agjencinë Kosovare të Privatizimit – <i>[shënimin shpjegues nr. 14.1]</i>	+	1,077,504
Rimbursimi i mjeteve nga llogaritë e NSh-ve për koston fikse të OShP-së	+	172,380
Gjendja bankare e llogarisë së tarifës administrative më 31 Dhjetor 2018		142,447

TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE

TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Janë transaksione bankare ndërmjet llogarive bankare të fondeve në mirëbesim në BQK. Shkurtimisht janë paraqitur si më poshtë:

1. Shpërndarja e 75% nga llogaritë e privatizimit për në llogaritë bankare të likuidimit prej **EUR 203,682**;
2. Transferimi i gjendjes bankare të NSh-ve në tranzicion prej **EUR 53,674**. Mjetet janë transferuar për në llogaritë bankare të likuidimit;
3. Bartjen e BID depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit për në llogaritë përkatëse të NSh-ve në likuidim. *Këto raste trajtohen dhe janë të paraqitur në shënimin nr. 1, 4 dhe 5.* Gjithsej shuma e transferuar prej **EUR 1,806,020**;
4. Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative nga llogaritë e NSh-ve përkatëse në vlerën prej **EUR 172,380**; Këto mjete janë kompensuar nga pagesat e realizuar ndër-vite të kostos fikse dhe variabile me OShP-në;
5. Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative nga llogaritë e NSh-ve përkatëse në vlerën prej **EUR 111,067**; Këto mjete janë kompensuar nga pagesat e realizuar për shpenzimet e NSh-ve të cilat nuk kanë pasur mjeteve për ekzekutim të pagesave;
6. Të hyrat e realizuara transferuara për tarifën administrative prej **EUR 1,077,504** nga **5% i tarifës administrative, konfiskimi i BID depozitave si dhe tarifa për pjesëmarrje në tenderë**;
7. Transferimin e shumave të pa shpërndara si pjesë e 20% për në llogarinë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve. **Gjatë periudhës raportuese**, gjithsej shuma e transferuar për punëtorët në llogari që mbahet në mirëbesim nga AKP është **EUR 435,990**. Këto mjete do të shpërndahen pas shqyrtimit të ankesave nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE

Është vetëm një llogari bankare në të cilën ka mjete bankare që AKP-ja mbanë në Procredit Bank:

1. Garancioni bankar për MIM Golesh në shumën prej **EUR 64,466.50** për licensën sipas rregullorës të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.

GJENDJA E FONDEVE TË LIKUIDIMIT TË NSh-ve

PERIUDHA 2005 - 2018

NR.	LLOJI I TË ARDHURAVE	PËRSHKRIMI I TË HYRAVE	VLERA
1	Shitje e asetëve	i1 - Shitje gjatë likuidimit	124,531,366
2	Shitje e asetëve	i3 - Depozita të transferuara nga llogaria e depozitës së tenderëve	11,167,290
3	Shitje e asetëve	i1a - Shitjet e banesave	262,676
4	Shitje e asetëve	Të ardhurat e Likuidimit nga SHPRONESIMI I ASETËVE	844,166
5	Qiraja	i12 - Të ardhura nga qiraja	20,296,523
6	Interesi	i2 - Interesi i fituar	8,388,625
7	Të ardhura tjera	i4 - TVSH hyrëse	532,714
8	Të ardhura tjera	i8 - Transferimi i depozitave të parave të gatshme	23,029
9	Të ardhura tjera	i13 - Të ardhura tjera	684,941
10	Të ardhura tjera	i9 - Transferim nga llogaritë bankare të NSh-ve	863,110
11	Të ardhura tjera	i10 - Pranimet nga debitorët e NSh-ve	121,528
12	Nga shitja të Nder. Reja	i6 - Transferimi i 75% nga shitjet me privatizim	443,675,113
13	Nga shitja të Nder. Reja	i7 - Transferimi i parave të NSh-ve në mirëbesim	10,888,568
GJITHSEJ TË HYRAT NË LLOGARITË BANKARE TË NSh-vë NË LIKUIDIM			622,279,649

NR	SIPAS LIGJIT NR. 04/L-034	PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE <i>(plani kontabël detajet e shpenzimeve të kategorizuar sipas renditjes të mësipërme janë në faqen tjetër)</i>	VLERA
1	Rreg. për punëtorët	Mjetet që u takojnë punëtorëve (20%) nga shitjet me likuidim	23,089,802
2	neni 21 i AKP-së i Ligjit nr. 04/L-034	Tarifa administrative e Agjencisë (5% e shitjeve të likuidimit dhe interesit në llogaritë bankare)	7,091,124
3	40.1.1	Kostot e Shitjes ose Përndryshe Realizimi i pronës ose asetëve si dhe shpenzimet e likuidimit	1,190,206
4	40.1.3.1	Shpenzimet Gjyqësore	114,063
4	Ekzekutim nga përmbaruesi	nga përmbaruesi privat në kundërshtim me nenin 10 të shtojcës të Ligjit	631,690
5	40.1.3.2	Shpenzimet e Administratorit, Autoritetit të Likuidimit dhe Këshilltarëve tjerë	15,500,109
6	40.1.3.3	Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe asetëve	2,664,005
7	40.1.3.4	Shpenzimet për vazhdimin e operacioneve të Ndërmarrjes	7,381,812
8	40.1.3.4	Shpenzimet të likuidimit: Pagesa e tatimeve (Tatimi i të Ardhurave Personale, Tatimi i Pronës, TVSH etj.)	3,652,273
9	40.1.4	Kreditorët e siguruar për ato raste që janë realizuar nga sigurimi i atyre asetëve	48,652 €
10	40.1.6.1	Kreditorët e pagave për 3 muaj pagat bruto dhe pensioni	2,531,102
11	40.1.6.2	Kreditorët: pagesat për pushim nga puna të papaguara në fillim të Likuidimit	3,709,960
12	40.1.7	Kreditorët e pasiguruar	19,647,903
13	40.1.8	Kreditorët - Pronarët, aksionarët, themeluesit, pjesëmarrësit ose partnerët në NSh	516,395
14	Shih shënimin nr. 17	Fondet Tepçicë, Fondet e Mbetura dhe Fondet e përkohshme transferuar Buxhetit të Kosovës	176,717,033
GJITHSEJ PAGESAT NGA LLOGARITË BANKARE TË NSh-ve NË LIKUIDIM			264,486,129

GJENDJA E LLOGARISË BANKARE TË NSh-ve NË LIKUIDIM 357,793,520

RENDITJA	PËRSHKRIMI	VLERA
1	e2 - Transferim tek punëtorët (BSPK)	16,976,272
	e3 - Transferim tek llogaritë në mirëbesim për punëtorët	6,113,530
2	e4 - Tarifa administrative e agjencisë (5% e shitjeve me likuidim)	6,719,142
	e4a - Tarifa Administrative e Agjencisë (5% e interesit në llogarinë bankare të likuidimit)	371,982
3	e1 - Shpenzimet bankare	25,202
	e6 - Shpenzime për reklamim	722,505
	e7 - Kostoja e shitjes për likuidim të aseteve	59,539
	e8 - Gjëra për zyrë, shpenzime të vogla zyre dhe posta	275,359
	e9 - Magazinim, transportim i dokumenteve të Nsh-ve	8,967
4	e11 - Shpenzimet e imta të MBYLLURA - Shpenzime aktuale për kosto të vogla likuidimi	98,635
	e14 - Shpenzime për gjykatë	114,063
5	e14a - ekzekutimi i pagesave nga përmbartuesi	631,690
5	e16 - Ofrues Profesional të Shërbimeve (Autoriteti i Likuidimit)	15,500,109
6	e21 - Shërbime për mirëmbajtje të aseteve	43,458
	e22 - Shërbime për mbrojtje të pronës dhe aseteve	2,620,547
7	e17 - Ofrues të shërbimeve (pagesa bruto)	1,504,397
	e18 - Ofrues të shërbimeve (pagesa neto)	2,977,861
	e25 - Qiraja e paguar (bruto)	159,120
	e26 - Qiraja e paguar (neto pas tatimit mbi qiranë)	35,736
	e20 - Shërbime profesionale	208,880
	e27 - Mallra	148,899
	e29 - Shërbime	549,399
	e30 - Ujë	152,389
	e31 - Rrymë	1,202,890
	e32 - Mbeturina	370,126
8	e33 - Telekomunikacion (Internet, telefon)	32,743
	e24 - Udhëtime zyrtare	39,372
	e19 - Tatimi në të ardhura personale për Ofrues të Shërbimeve	511,147
	e34 - Tatimi që mbahet mbi qiranë e paguar	2,995
	e35 - Tatimi i paguar për qiranë e pranuar	88,249
	e36 - Tatimi komunal në pronë	634,236
	e38 - Tatimi i korporatës	277,523
8	e39 - TVSH paguar ATK-së	2,138,122

9	e41 - Kreditorë të siguruar	48,652
10	e43 - Pagat (neto) kreditorë preferencialë 3 paga	2,219,681
	e44 - Tatimi në ardhurat personale (kreditorë preferencialë 3 paga)	63,914
	e45 - Kontribute për pension (për kreditorë preferencialë 3 paga)	247,507
11	e46 - Pagesa për ndërprerje të punësimit (neto) kreditorë preferencialë	3,239,759
	e47 - Tatimi në të ardhura personale (pagesa për ndërprerje të punës kreditorë preferencialë)	122,688
	e48 - Kontributi për pension (për pagesë të ndërprerjes së punës për kreditorë preferencialë)	347,513
	e49 - Pagat (neto) kreditorë të pasiguar	5,934,762
12	e50 - Tatimi në të ardhura personale (pagat e kreditorëve të pasiguar)	818,268
	e51 - Kontribute për pension kreditorë të pasiguar	1,881,978
	e52 - Kreditorët e pasiguar - Huazimet	135,755
	e53 - Avanset e pranuar në para të gatshme nga Nsh-të - kreditorë të pasiguar	200,586
	e54 - Furnizues vendorë kreditorë të pasiguar	2,612,415
	e55 - Furnizues ndërkombëtarë kreditorë të pasiguar	28,680
	e56 - Tatimi në pronë - kreditorë të pasiguar	1,330,068
	e57 - Tatimi mbi qiranë kreditorë të pasiguar	65,715
	e58 - Tatimi i korporatës kreditorë të pasiguar	504,614
	e59 - TVSH kreditorë të pasiguar	3,934,267
	e60 - Tatimi i paragjykuar kreditorë të pasiguar	230,627
	e61 - Rryma kreditorë të pasiguar	677,852
13	e62 - Ujë kreditorë të pasiguar	263,194
	e63 - Mbeturina kreditorë të pasiguar	180,007
	e64 - Telekomunikim dhe Internet kreditorë të pasiguar	51,117
14	e65 - Kreditorë tjerë të pasiguar	797,997
	e66 - Kërkesa të pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve, partnerëve në Nsh	516,395
14	e0 - Fondet Tepricë për Qeverinë e Kosovës - neni 19.3.3 i Ligjit të AKP-së	90,244,911
	Fondet e përkohsme transferuar Buxhetit të Kosovës	43,920,007
	e67 - Fondet e mbetura për Qeverinë e Kosovës	42,552,116

LLOJET E LLOGARIVE BANKARE

1. **LLOGARITË E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për të mbajtur të ardhurat e privatizimit/shitjes sipas nenit 8 deri në nënshkrimin e kontratave të shitjes. Pas nënshkrimit të kontratave të shitjes, bëhen këto veprime: pagesat për 20%-in e punëtorëve; transferimi i tarifës administrative (5% e shitjes) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 75% e çmimit të shitjes transferohen në llogarinë e likuidimit.
2. **LLOGARITË E NSh-ve NË TRANZICION** - Mban paratë e NSh-ve në mirëbesim në rastet kur Agjencia vendos që NSh-ja nuk ka resurse për të mbajtur këto para ose kur rrethanat nuk e lejojnë për të vepruar ndryshe për shkak të specifikave të NSh-ve (rasti i statuseve të pa përcaktuara të NSh-ve e të ngjashme).
3. **LLOGARITË E LIKUIDIMIT** - Përdoren për NSh-të pasi që kanë hyrë në likuidim. Të gjitha llogaritë bankare e NSh-ve mbyllen dhe gjendja e tyre bankare transferohet në këto llogari.
4. **LLOGARIT E KOMERCIALIZIMIT** - Mban shumat e qirave të mbledhura gjatë procesit të komercializimit të NSh-ve, pra të kontratave të nënshkruara para privatizimit të NSh-ve dhe ato kontrata të koncesionit ose dhënies me qira që nënshkruhen pas themelimit të Agjencia Kosovare të Privatizimit. Pas përfundimit të kontratës së komercializimit bëhen këto veprime: transferimi i tarifës administrative (5% e qirave të paguara gjatë komercializimit) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 95% e të ardhurave nga komercializimi transferohen në llogarinë e likuidimit, nëse nuk parashihet ndryshe.
5. **LLOGARITË E PARAVE NË MIRËBESIM PËR PUNËTORËT** - Mban paratë në mirëbesim në emër të punëtorëve që janë transferuar nga llogaritë e privatizimit dhe likuidimit. Këto para janë pjesa e mbetur e 20%-it që iu takon punëtorëve në rastet kur më parë është bërë shpërndarja e parakohshme e 20% e të ardhurave nga shitjet sipas nenit 8 dhe 20% e të ardhurave nga shitja sipas nenit 9 të ligjit të Agjencisë.
6. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për mbajtjen e depozitave të paguara nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit mbi AKP-në. Kjo është një llogari e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitin e ofertës ofertuesit jo fitues (të pasuksesshëm). Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për Ndërmarrjen e Re që shitet.
7. **TARIFAT PËR TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për

shitjet sipas nenit 8 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.

8. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për shitjet sipas nenit 9 për mbajtjen e depozitave të paguar nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjen e pasurive të NSh-ve që janë në likuidim. Kjo është një llogari bankare e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitin ofertuesit të pasuksesshëm. Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për NSh në likuidim.
9. **TARIFAT PËR TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 9 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.
10. **DEPOZITAT E KOMISIONIT TË RISHIKIMIT TË LIKUIDIMIT** - Ka mbajtur depozitat e paguara nga parashtuesit për ankesat në procesin e likuidimit të dorëzuara në ish-Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Pas kthimit të depozitave siç parashihet në nenin 24.4 të ligjit të Agjencisë, kjo llogari do të mbyllet.
11. **LLOGARIA E KAPITALIT THEMELTAR** - Mban pagesën në kapital nga Buxheti i Kosovës mbi themelimin e Agjencisë
12. **LLOGARIA E FONDIT REZERVË TË AKP-së** - Para se të hyjë në fuqi ligji i ri për 5% e tarifës administrative është mbajtur për të përdorur të ardhurat vetanake të AKP-së për depozitat e konfiskuara nga shitjet e privatizimit, likuidimit, transferimin e tarifave për shitjet përmes privatizimit dhe likuidimit, interesin e fituar në llogaritë e depozitave dhe tarifave për pjesëmarrjen në tenderët e shitjes përmes privatizimit apo likuidimit.
13. **LLOGARIA E DONATORIT** - Mban paratë e donatorëve në rastet kur donatorët kërkojnë që paratë e tyre të kanalizohen përmes llogarive bankare të Agjencisë.
14. **LLOGARIA E TARIFËS ADMINISTRATIVE** - Në këtë llogari transferohet tarifa administrative e Agjencisë. Në periudha të ndryshme, Agjencia transferon gjendjen në këtë llogari bankare në llogarinë e specifikuar nga Ministria e Financave për të mbajtur të ardhurat e dedikuara nga tarifat administrative të Agjencisë.
15. **LLOGARIA E DEPOZITAVE KOHOR** - Janë llogaritë bankare të depozitave kohor në të cilat transferohet mjetet për afatizim për periudha të ndryshme (deri në një vjet). Nëse ka norma të interesit pozitive që oferton BQK-ja, atëherë sipas marrëveshjes AKP afatizon këto mjete në Bankën Qendrore të Kosovës.
16. **LLOGARIA E SHPRONËSIMEVE** - Llogari për qëllim të administrimit dhe operimit me pagesa e shpronësimeve nga institucionet relevante. Të gjitha institucionet kanë mundësi që pagesën ta përfundojnë menjëherë pa ndjekur procedurat e Thesarit për regjistrimin si furnitorë të NSh-ve. Mjetet që pranohen në këtë llogari, nga AKP-ja transferohen në llogaritë përkatëse të NSh-ve, prej nga është shpronësuar aset.

PLANI I VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM (AP) TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS TË DHËNA NË RAPORTIN E AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË VITIT 2017 PËR FONDET NË MIRËBESIM

Nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
1.	2.2	10	Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj që të gjitha shpenzimet buxhetohen, realizohen dhe raportohen në përputhje me Legjislacionin në fuqi. Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj prezantimin e drejtë dhe të plotë të informatave në pasqyra financiare lidhur me shpalosjen e detyrimeve kontingjente. Gjithashtu, duhet vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve për vitin 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	- Bordi i Drejtorëve; - Menaxhmenti i AKP-së; - Departamenti i Financave dhe Buxhetit.	31 dhjetor 2018	Ky rekomandim veçse është adresuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr.06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/L-34 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr.04/L-115 dhe me ligjin nr.05/L-080. Më konkretisht, Neni 16 i këtij ligji e përcakton mënyrën e kompensimit të Ofruesve të Shërbimeve Profesionale dhe shpenzimeve tjera të likuidimit. Edhe pse prej vitit 2012, ZKA e ka kualifikuar opinionin lidhur me PFV-të e Fondeve në Mirëbesim, përmes ndryshimeve të këtij ligji, konfirmohet tani edhe formalisht mënyra të cilën e kishte praktikuar AKP-ja lidhur me kompensimin e OSHP-ve përgjatë këtyre viteve. Po ashtu, si pjesë e adresimit të plotë të këtij rekomandimi është edhe fakti se, Departamenti Ligjor ka siguruar një prezantim të

Nr.	Neni në raport	Faqe	Referencë	Rekomandimi i Auditorit të Përgjithshëm	Departamenti përgjegjës për zbatim	Afati për zbatim	Komentet
							drejtë dhe të plotë të informatave lidhur me detyrimet kontigjente për Pasqyrat Financiare 2018.
2.	3.2.1	13	Të hyrat nga qiratë	Kryesuesi i Bordit: Duhet të siguroj ripërtëritjen e kontratave me qëllim që shfrytëzimi i aseteve të NSH-ve të bëhet konform kontratave valide dhe në bazë të rregullores së brendshme për qiratë.	- Menaxhmenti; - Autoritetet e Likuidimit; - Departamenti i Koordinimit Rajonal.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	
3.	3.3	14	Pagesat / shpërndarjet e 20% të punëtorëve të transferuar në BSPK	Kryesuesi i Bordit: Duhet të sigurohet se pas përfundimit të procedurave relevante të ankesave të bëhet shpërndarja e plotë e 20% që ju takon punëtorëve pas çdo shitje të aseteve të NSH-ve.	- Menaxhmenti; - Komisioni i Listave të 20% të Punëtorëve. - Departamentet dhe Njësitë përkatëse brenda AKP.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	
4.	4.	16	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryesuesi i Bordit: Duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve që janë në proces të zbatimit, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor për zbatimin e plotë të tyre, përfshirë edhe stafin llogaridhënës. Zbatimi duhet të monitorohet në vazhdimësi.	- Menaxhmenti ; - Departamenti i Financave dhe Buxhetit; - Departamenti i Koordinimit Rajonal; - Njësia e Kontrollit dhe Mbikëqyrjes.	31 dhjetor 2018 (Në vazhdimësi)	Menaxhmenti përgjatë gjithë vitit e bën azhurnimin e planeve të adresimit të rekomandimeve të ZKA-së. Po ashtu, në vazhdimësi bëhet edhe monitorimi i zbatimit të këtyre planeve.